

Joschka Fischer

**Viti
vendimtar
i Europes**



Panorama

**Sfidat
gjeopolitike
te 2015-es**



FT

**Rusia,
ose loja e
pasqyrave**

Politika

Botim elektronik i ASP ne bashkepunim me Bota.al • Dhjetor 2014

Vetmia e xhandarit global

Nga Slavoj Zizek



Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Botim elektronik i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me Bota.al

bota.al

Friday, June 20, 2014

HOME BOTA EKONOMI TEKNOLOGJI HISTORI SHKENCE KULTURE DOSSIER SPORT

INTERVISTA/Habermas: Propozimi im për një Union më demokratik

Jürgen Habermas është sociolog dhe filozof gjerman, i traditës së teorisë kritike dhe pragmatizmit. Ai është bërë i njohur për teoritë e tij të racionalitetit të komunikimit dhe sferës publike. Sipas sondazheve globale, Habermasi pranohet gjerësisht si një prej...

June 19, 2014

BOTIMESHQIP.COM

Në Shqipëri ju i merrni librat brenda 24 orëve dhe i paguani lehtë në dorë kur merrni librat.

Në çdo vend tjetër të botës ju i merrni librat brenda pak ditësh dhe mund të paguani me PayPal, transferë bankare, etj.

botimeshqip.com
Libri Shqip në shqipëri tani!

Kontaktet:
Akademia e Studimeve Politike
Adresa:
Qendra Kotoni,
Rr.Donika Kastrioti,
Nr.3,
Kati 4, Zyra 2,
Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 227 2173,
Tel: +355 4 450 4788
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al
dhe www.bota.al

Përzgjedhja, redaktimi dhe përkthimi i materialeve në këtë buletin kryhet nga alumni i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, z. Ermal Gjinaj



PER POLITIKEN:

Për mua, është e domosdoshme të krijoj një imazh fituesi, kështu që, më duhet të mund dikë...

Richard Nixon

Një prej penalteteve për mospërfshirjen në politikë, është se përfundon të qeverisesh nga njerëz që janë inferiorë

Platoni

Vendet më të errët të Ferrit u janë rezervuar atyre që ruajnë neutralitetin në kohë krize

Dante Aligieri

Politika është lufta pa gjakderdhje, ndërsa lufta është politikë me gjakderdhje

Mao Cedun

Politikanët e këqinj dërgohen të qeverisin, prej njerëzve të mirë që nuk votojnë

William E. Simon



Vetmia e xhandarit global

SLAVOJ ZIZEK

Në fund të muajit shtator, pasi i shpalli luftë shtetit islamik të ISIS-it, presidenti amerikan Barack Obama në një intervistë televizive në emisionin e njohur “60 minuta”, u përpoq të shpjegonte rregullat e drejtimit amerikan të globit: “Kur ka probleme në ndonjë cep të botës, nuk thërrasin në ndihmë Pekinin apo Moskën. Na kërkoni ne. Ka qenë përherë kështu. Amerika drejton të tjerët! Jemi një komb i domosdoshëm”. E njëjta gjë vlen edhe për katastrofat mjedisore apo ato humanitare: “Kur një tajfun godet Filipinet, vëzhgoni se kush ndihmon filipinasit, për të përballuar emergjencën civile. Kur bie një tërmet në Haiti, shihni kush merret me rindërtimin e vendit. Kështu funksionon Amerika. Është kjo ajo çka na bën amerikanë”.

Megjithatë në mesin e muajit tetor, Obama zhvilloi një bisedë telefonike me Teheranin dhe i dërgoi një letër sekrete Ajatollahut Ali Khamenei, ku këshillonte një riazim thelbësor mes SHBA-ve dhe Iranit, mbi bazën e interesit të përbashkët për të luftuar xhihadistët e shtetit islamik të ISIS-it. Irani jo vetëm që e refuzoi këtë ofertë, por kur nisma e Obamës u publikua në media, republikanët e cilësuan atë qesharake dhe njëherazi poshtëruese. Sipas tyre, ky gjest do të ushqejë bindjen arrogante të Iranit se SHBA janë realisht një superfuqi botërore në perëndim.

Në fakt është kjo mënyra sesi funksionon Amerika në realitet. Duke vepruar e vetme në një botë multipolare, ajo fiton vazhdimisht luftërat dhe humbet paqen, duke kryer punët e pista të të tjerëve: të Kinës apo dhe Ruisë që kanë problemet e tyre me islamikët, duke ndihur në këtë drejtim edhe vetë Iranin. Rezultati përfundimtar i pushimit të Irakut, ishte dorëzimi i kontrollit politik të vendit në duart e Teheranit. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Afganistanin më herët, ku ndërhyrja e Uashingtonit kundër pushtimit sovjetik prodhoi talebanët.

Nuk mbetet më pak problematik roli i ri që SHBA ka në ekonominë botërore. Një cikël ekonomik ndodhet tashmë në muzgun e tij. Ky cikël kishte nisur në fillim të viteve '70, kur lindi ai që Janis Varufakis e cilëson si "Minotauri Global", motori i përbindshëm që shtyu ekonominë botërore nga fillimi i viteve '80 dhe deri në vitin 2008. Fundi i viteve '60 dhe fillimi i viteve '70, nuk ishin thjeshtë periudhë e një kize ekonomike dhe stanjacioni. Vendimi i presidentit amerikan, Riçard Nikson, për të braktisur konvertimin e dollarit, ishte shenja e parë e një ndryshimi shumë më radikal në funksionimin e sistemit kapitalist. Në fund të viteve '60, ekonomia amerikane nuk mund të riciklonte më tepricat e veta në Evropë dhe Azi dhe kjo pasi ato tashmë ishin shndërruar në deficiente.

Në vitin 1971, Uashingtoni reagoi ndaj kësaj situate në mënyrë mjaft kurajoze: në vend se të kufizonte defiçitin gjithnjë e më të madh, vendosi të bënte të kundërtën dmth ta rriste atë. Por kush do të vuante pasojat? Sigurisht pjesa tjetër e botës. Në ç'mënyrë? Përmes transferimit të vazhdueshëm të kapitaleve nga njëra anë e oqeanit në tjetrën, për të mundësuar kështu financimin e defiçitit. SHBA kanë nevojë për 1 miliardë dollarë në ditë nga vendet e tjera, për financimin e konsumin të tyre të brendshëm. Në këtë kuptim janë konsumatorët universalë kejnesianë, ata që udhëheqin ekonominë botërore.

Ky rrugëtim parash, bazohet në një mekanizëm ekonomik mjaft të ndërlikuar: SHBA cilësohen si një partner i qëndrueshëm dhe i besueshëm, ndërsa gjithë të tjerët, nga prodhuesit arabë të naftës, Evropa Perëndimore, Japonia dhe tashmë madje edhe Kina, investojnë atje fitimet e tyre. Dhe duke qenë se ky "besim" ka baza të shëndosha ideologjike dhe ushtarake më shumë sesa ekonomike, SHBA janë të detyruara që të justifikojnë sjelljen e saj imperialiste, përmes një gjendje lufte të përhershme, duke u shpërfaqur si mbrojtëse universale e të gjitha vendeve "normale" kundër "shteteve të poshtra".

Megjithatë, para se të arrinte të afirmohej plotësisht, sistemi global i bazuar tek supermacia e dollarit si monedhe universale, filloi gradualisht të shkërmoqej, duke lënë një boshllëk që ende nuk është mbushur. Nga kjo varen edhe tensionet aktuale. "Shekulli amerikan" ka mbaruar dhe tashmë po krijohen qendra të tjera të kapitalizmit botëror: SHBA, Evropa, Kina, ndoshta edhe Amerika Latine. Secila prej tyre mbështet formën e saj të veçantë të kapitalizmit. SHBA janë kalorësit e kapitalizmit neoliberal, Evropa mbron atë çka mbetet ende nga shteti social, Kina ruan me fanazitëm kapitalizmin e saj të "vlerave aziatike" (ose thënë ndryshe autoritarizmin), në një kohë që Amerika Latine preferon kapitalizmin populist. Superfuqitë e vjetra dhe të reja po studiojnë njëra-tjetrën dhe secila tenton që të imponojë variantin e saj të rendit botëror, dhe që si fillim e eksperimenton me shtetet satelite që ka rreth e rrotull.

Gjendja aktuale i përngjan asaj të fillimit të viteve 1900, kur hegjemonia e Perandorisë Britanike po kontestohet nga fuqitë e reja në rritje e sipër, sidomos nga Gjermania, të cilat donin një copë nga torta e kolonive. Ballkani ishte një prej rajoneve për të cilat rivalizohej. Sot rolin e dikurshëm të Perandorisë Britanike e luan SHBA, fuqitë e reja në rritje janë Rusia e Kina, ndërsa Ballkani i djeshëm është Lindja e Mesme sot. Është pra beteja e zakonshme për ndikim gjeopolitik. Jo vetëm SHBA por edhe Moska thotë se ka marrë kërkesa për ndihmë nga Gjeorgjia dhe Ukraina dhe ndoshta shumë shpejt "lutje" të ngjashme do të ketë edhe nga 3 vendet e vogla balltike, Estonia, Lituania dhe Estonia.

Ekziston një tjetër paralelizëm interesant mes gjendjes aktuale dhe asaj që i parapriu shpërthimit të Luftës së Parë Botërore: muajt e fundit mjetet e informimit publik vazhdimisht paralajmërojnë mbi rrezikun e një lufte të tretë botërore. Së paku një herë në javë, presidenti rus Vladimir Putin lëshon një deklaratë që interpretohet prej perëndimit si një provokim. Një politikan perëndimor apo një përfaqësues i NATO-s flet për ambicje imperialiste të Rusisë. Në kundërpërgjigje të këtyre akuzave, Moska shpreh shqetësim mbi sjelljen e NATO-s kundrejt fqinjëve të saj, duke filluar kësaj t'i frikësohet një pushtimi të mundshëm. Tonet e ububushme të këtyre deklaratave nuk bëjnë gjë tjetër veçse rrisin më tej tensionin, saktësisht sikurse ndodhi para vitit 1914. Është një mekanizëm supersticioz, sikur të flisnim për një katastrofë që mund të shmangim. Njohim rrezikun, por nuk mendojmë se mund të jetësohet në realitet dhe pikërisht është kjo bindje që e shndërron atë në një rrezik të mundshëm. Më fjalë të tjera, edhe pse nuk mendojmë se çfarë mund të ndodhë, duhet të përgatitemi gjithësesi për gjëmën. Këto parapërgatitje, gjerësisht të injoruar nga mjetet kryesore të komunikimit, gjejnë hapësirë vetëm në mediat periferike. Në 3 Dhjetor të këtij viti, televizioni "Russia Today" raportonte: "Prej më shumë se 10 vitesh, Pentagoni po mendon seriozisht mundësinë e një Luftë të Tretë Botërore, por tashmë aksioni ushtarak kundër Rusisë ka kaluar në hartimin e planeve konkrete. Masat e sigurisë që nga Lufta e Ftohtë nuk vlejnë më. Në 4 Dhjetor 2014, miratimi i një ligji të rëndësishëm nga ana e Kongresit (rezoluta 758) autorizon (në pritje të votimit të senat) presidentin e Shteteve të Bashkuara që të nisë një përballje ushtarake me Rusinë pa aprovimin e Kongresit...". Në 3 Dhjetor, Ministri rus i Mbrojtjes, njoftoi krijimin e një njësie të re politiko-ushtarake, që do të mbajë nën kontroll të gjitha kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare në kohë paqe, por që do të merret drejtimin e situatës, në rast se vendi do të gjendet në luftë. Ajo që i komplikon më tepër gjërat, është fakti se superfuqitë e vjetra dhe te reja duhet të përballen edhe me radikalizmin e lëvizjeve fundamentaliste që sa janë armiq me të gjithë, aq edhe të gatshëm të lidhin aleanca strategjike me ndonjë prej tyre. Nuk është çudi që kjo gjendje të ndërlikohet gjithnjë e më shumë duke të çuar drejt pyetja: Kush lufton kë? Si mund të zgjedhësh mes Bashar al Assad-it dhe ISIS-it në Siri? Po mes ISIS dhe Iranit? Kjo çoroditje – për të mos folur për rolin gjithnjë e më të rëndësishëm të dronëve dhe armëve të tjera, që premtojnë një luftë teknologjike pa të vdekur (të pakën jo në anën tonë) – nxit rritjen e shpenzimeve ushtarake dhe e bën më të pranueshme perspektivën e një lufte.

Nëse koncepti thelbësor i luftës së ftohtë ishte i ashququajturi MAD ("shkatërrimi i ndërsjellë i garantuar" por vetë akronimi në anglisht do të thotë i "çmendur"), aksioma e luftës aktuale ndaj terrorizmit, duket të jetë e kundërta ose NUTS (Nuclear Utilization Target Selection, "përzgjedhja e shënjeshtrove kundër centraleve bërthamore") akronimi do të thotë "i çmendur pas garave", ose ideja që përmes një sulmi kirurgjik, mund të shkatërrohen instalimet nukleare të armikut, ndërsa një predhë antiraketë do të na mbrojë nga kundërsulmi.

Më qartë akoma, SHBA përdorin një strategji të diferencuar: reagojnë sikur të vazhdonin me logjikën e MAD-it në marrëdhëniet me Rusinë dhe Kinën, por në të njëjtën kohë joshen nga sistemi NUTS, për të zgjidhur problemet me Iranin dhe Korenë e Veriut. Mekanizmi paradoksal i MAD-it, tjetëron logjikën se "profecia do të vetërealizohet", duke e transformuar në "një synim që vetëçudit": fakti se në rast të një sulmi bërthamor, armiku mund të kundërpërgjigjet me një forcë po aq shkatërruese, është garanci se askush nuk do të fillojë një luftë të tillë. Përkundrazi, logjika e NUTS-it, është që armiku mund të detyrohet të ç'armatohet, në rast se jemi të aftë ta godasim, pa rrezikuar një kundërsulm. Zbatimi i dy strategjive kontradiktore në të njëjtën kohë e po të njëjtës fuqi, dëshmon pikërisht absurditetin e të gjithë arsytimit.

Çfarë mund të bëjmë për të ndalur një vokacion të tillë? Hapi i parë, sigurisht

është hedhja pas krahëve e të gjithë fjalimeve pseudoracionale mbi “rreziqet strategjike” që duhet të marim përsipër, së bashku me konceptin e kohës historike si një proces evolutiv linear, në të cilin në çdo moment duhet që të zgjedhim mes disa mundësive. E vërteta është se duhet që të pranojmë kërcënimin. Nuk bëhet fjalë vetëm për të evituar rrezikun e të marrit vendime korrekte në kuadër të peisazhit global, pasi kërcënimi i vërtetë përfaqësohet pikërisht nga situata aktuale në tërësinë e vet, nga “fati ynë”: nëse vazhdojmë të reagojmë si kemi bërë deri më tani, jemi të dënuar nga kujdesia me të cilën ne vetë lëvizim. Zgjidhja nuk është të jesh i kujdesshëm dhe të shmangësh aksione të rrezikshme, sepse në këtë mënyrë nuk bëjmë gjë tjetër veçse marrim pjesë aktivisht në logjikën që çon drejt katastrofës. Zgjidhja është të bëhemi tërësisht të ndërgjegjshëm mbi lidhjet e ngjarjeve të rrezikshme, që e bëjnë në tërësi situatën jashtëzakonisht të rrezikshme. Paskëtaj duhet që t’ia fillojmë punës së vështirë e të gjatë për të ndryshuar kahjen e të gjithë këtij skenari. Tjetër zgjidhje unë nuk shoh.

* Slloveni Sllavoj Zizek është një filozof dhe studiues i psikanalizës. Libri i tij i fundit botuar këtë vit titullohet “Objekti sublime i ideologjisë.”



Mrekulli amerikane

SLAVOJ ZIZEK

Imagjinoni një historiane që merret me ekonominë në vitin 2050, duke u folur studentëve të saj për shpikjet më të rëndësishme të fillimit të shekullit 21 – do-methënë “Modelet TS”, “fluturakët ërigh” dhe Penicilinat e kohës sonë. Cila do të ishte lista e saj?

Sigurisht, “fracking” – shkurtimi për kombinimin e shpimeve horizontale dhe copëtimit, një proces që po e bën Amerikën prodhuesin numër një të naftës dhe gazit në botë – do të jetë në listë. Po kështu mediat sociale – “farmaku” i autokratëve si Erdogani apo i prindërve si unë – gjithashtu do të përmenden. Aplikacionet e celularëve? Patjetër. Shkenca në zhvillim e imunoterapisë së kancerit? Të shpresojmë.

Pasi të ketë hartuar këtë listë, historiania jonë të vërejë më pas që, secila prej këtyre risive ka të stampuar mbi vete “Made in USA”. Sa e çuditshme, mund të thotë ajo, që kaq shumë amerikanë në atë kohë kanë harxhuar kaq shumë nga dita e tyre duke u qarë për gjendjen e mjeruar të shkollave të tyre, natyrën e paralizuar të politikës, barrat fiskale si dhe parashikimet për rënien e afërt. Ndoshta ngaqë jam rritur si një amerikan që jetonte jashtë vendit të tij, unë vetë kam qenë gjithmonë tejet i habitur prej largësisë mes arritjeve të Amerikës dhe perceptimit që amerikanët kanë për vetveten. Edhe sot e kësaj dite jam i çuditur që, në SHBA, unë mund të pi ujë direkt nga rubineti, që një polic nuk më ka kërkuar asnjëherë një “kontribut”, që valixhja ime nuk është vjedhur asnjëherë, që askush nuk rrëmbehet për para, që spastrimet politike të llojit Maoist ndodhin vetëm në editorialët e New York Times.

Provoni të thoni të njëjtën gjë për jetën e përditshme në Brazil, Rusi, Indi, Kinë apo Afrikën e Jugut – të ashtuquajturit vende Brics, që dikur një guro i Goldman

Sachs i ka quajtur ekonomitë e të ardhmes.

Por t'i kthehemi historianes sonë në të ardhmen. Përse, mund të pyesë ajo studentët, SHBA dominoi të tjerët kur realizoi gjithë këto shpikje të mëdha?

“Fracking” do të ishte një rast studimor shumë i mirë. Revolucioni ndodhi në SHBA jo për shkak të ndonjë avantazhi të madh në gjeologji – Kina, Argjentina dhe Algjeria kanë secila rezerva të mëdha shtresash argjilore prej ku mund të nxjerrin naftë dhe gaz. Nuk ndodhi për shkak se kompanitë e mëdha energjetike të Amerikës janë unike për nga aftësitë, dijet apo financat: Hidhini një sy raportit vjetor të ExxonMobil për vitin 2004 dhe vështirë se do të gjeni të përmendur “copëtimin” apo “shpimin horizontal”.

Nuk ndodhi as sepse mandarinët e iluminuar në burokracinë federale dhe laboratorët kombëtarë po vështronin në qoshet e të ardhmes. Në pjesën më të madhe, ata ishin të fiksuar pas etanolit qelizor dhe teknologjive të tjera që as nuk patën një start.

“Fracking” ndodhi në SHBA sepse amerikanët, pothuajse unikë në botë, kanë të drejta pronësia për mineralet që ndodhen poshtë “bahçeve” të tyre. Dhe sepse qeveria federale as nuk po kushtonte vëmendje. Dhe sepse federalizmi i lejon shtetet të bëjnë çfarë të duan. Dhe sepse sipërmarrës kundër rrymës si George Mitchell dhe Harold Hamm nuk përkulen përpara konsensusit të ekspertëve. Dhe sepse tregjet tanë të kapitalit ishin të gatshëm që të “vinin bast” kundër atyre ekspertëve.

“Kur flas me të huaj, ata janë edhe më të impresionuar se sa shumë amerikanë prej kësaj rilindjeje”, thotë kolegu im gazetar, Gregory Zuckerman, autor i “The Frackers”. “Ata e kuptojnë se një gjë e tillë mund të kishte ndodhur vetëm në Amerikë”.

“Fracking”-u tashmë ka ngritur në këmbë tregjet e energjisë, ka tronditur petro-diktatorët, ka shastisur OPEC-un, ka forcuar lidhjet ekonomike amerikano-ve-riore, ka reduktuar në nivelet më të ulët që nga viti 1995 lëshimin e gazrave në atmosferë si dhe ka ngulur një gozhdë në arkëmortin e shumicës së skemave të energjive të rinovueshme (ndonëse ai lloj zombie vështirë se mund të asgjësohet, gjë që me siguri historia jonë e ardhshme do ta dijë).

“Fracking” është një industri. Me kalimin e kohës, avantazhet që kjo teknologji i ka dhënë SHBA do të zbehen teksa ajo sa do të vijë e më shumë do të përhapet. Më pas, do të kalohet në shpikjen tjetër. Gjë që, mund ta themi se do të jetë me siguri amerikane në origjinë dhe projektim.

Këtu pra, është leksioni i madh për studentët i historianes sonë të ardhshme: Inovacioni varet më pak prej zhvillimit të ideve specifike, dhe më shumë prej krijimit të hapësirave të gjera. Autokracitë mund të kultivojnë gjithmonë kampionët e tyre të shahut, gjenitë e pianos dhe inxhinierët bërthamorë; ato mund të angazhojnë gjithmonë 1% të atyre në majë për të realizuar disa detyra. Problemi i autokracive është se çfarë të bëjnë me 99%-shin tjetër. Ato nuk kanë një përgjigje, përveçse të administrojnë, diktojnë dhe shtypin.

Një shoqëri e lirë, e cila është e gatshme të vërë miliona “baste” të vegjël për persona të panjohur dhe gjëra që nuk janë parë nuk e ka këtë problem. Fleksibiliteti dhe jo ngurtësia është prova e vërtetë e forcës. Suksesi është rezultat i eksperimentimit dhe jo projektimit. Dështimi është i tolerueshëm deri në atë masë sa përshtatja është e mundshme.

Ky është sekret i amerikan, që shpesh herë harrohet në Amerikë, sepse amerikanët nuk e imagjinojnë dot ndryshe. Është arsyeja përse ne jemi pakëz të habitur kur shohim që jemi të parët – edhe atëherë kur, apo sidomos atëherë kur presidentët tanë janë të kotë dhe politikat tona marrëzi.

Ne jemi më të mëdhenj se politikanët tanë. Jemi më të mirë se politika jonë. Jemi më të zgjuar se kultura jonë. Jemi më të mençur se idetë tona. Shijojini pushimet. /The Wall Street Journal/



Viti vendimtar i Europës

Joschka Fischer

Thuhet se kriza e euros ka marrë fund. Në tregjet financiarë është rikthyer qetësia, mes garancive të autoriteteve të Bashkimit Europian – veçanërisht Bankës Qendrore Europiane – se unioni monetar do të ruhet. Por ekonomitë e Europës jugore mbeten në depresion, dhe eurozona në tërësi po vuan prej stacionit, trysnisë deflacioniste, dhe në vendet në krizë, një vazhdimësi të papunësisë së lartë.

Nuk është çudi që, duke parë paaftësinë e dukshme të autoriteteve të BE për t'i dhënë fund “sëmundjes”, shumë shtete anëtarë janë duke humbur durimin me masat e kursimit. Në fakt, në disa prej tyre vihet re një trazirë politike.

Kur të mbërrijë lëkundja e fortë, ka gjasa që do të shkaktohet – ashtu si ndodhi edhe me krizën e euros – nga Greqia, e cila po mban zgjedhjet presidenciale që duket se nuk ka gjasa të nxjerrin një fitues. Nëse parlamenti grek nuk zgjedh një president të ri me dy të tretat e votave në raundin e tretë dhe të fundit që mbahet javën e ardhshme, ai do të shpërbëhet dhe do të thirren zgjedhjet e parakohshme. Rreziku është që Syriza, një parti socialiste e ekstremit të majtë, do të marrë pushtetin.

Që të fitojë, Syriza duhet ose të mashtrojë votuesit e vet në lidhje me opsionet që ka, ose të këmbëngulë se do të rinegociojë kushtet e shlyerjes së borxheve që i janë imponuar Greqisë nga ashtuquajtura Trojkë (Komisioni Europian, Banka Qendrore Europiane dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar), ndërkohë që do të vazhdojë me veprime të njëanshëm, nëse rinegociimi dështon. Por, çdo rinegociim që do të pasonte një fitore të Syrizës me shumë gjasë do të shkaktonte një ortek po-

litik në jug të BE, i cili do të merrte përpara gjithë programin e rreptësisë fiskale dhe do të rindizte flakë sërish krizën e eurozonës.

Sigurisht, Greqia vetë është shumë e vogël që problemet e saj të paraqesin ndonjë rrezik real për eurozonën. Por rezultati i zgjedhjeve në Athinë mund të shkaktojë panik në tregjet financiarë, duke shkaktuar kështu një krizë e cila do të rrezikon-te të zhvendosej në Itali, ekonomia e tretë më e madhe e eurozonës, dhe me pak vonesë, edhe në Francë, ekonomia e dytë më e madhe.

Mund të ndodhë një mrekulli: në Athinë mund të zgjidhet një president javën e ardhshme, ose Syriza mund të mos fitojë zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Fatkeqësisht, cilido rezultat thjeshtë do të shtynte në kohë një krizë të nxitur nga politika në BE. Në fund të fundit, edhe në Itali ka shenja që furtuna po afron. Dhe pasi të goditet Italia, radhën mund ta ketë Franca.

Konflikti në lidhje me masat e kursimit është bërë shpërthyes politikisht sepse ai po shndërrohet në një konflikt mes Gjermanisë dhe Italisë – dhe më keq, midis Gjermanisë dhe Francës, dyshja që ka udhëhequr integrimin europian për dekada të tëra. Dhe kjo po ndodh në një kohë kur forcat nacionaliste antieuropiane janë duke zënë vend në parlamentet rajonale dhe atë kombëtar në Gjermani – dhe në rrugë – duke ia reduktuar kështu së tepërmi hapësirën për kompromis Kancelares Merkel. Beteja mes mbrojtësve të masave të rreptësisë fiskale (kursimit) dhe kundërshtarëve rrezikon pra të shpërbëjë jo vetëm Eurozonën, por edhe BE si një i tërë.

Kriza në eurozonë dhe refuzimi për të bërë një përpjekje për një qasje europiane ndaj rikthimit të rritjes ekonomike ka kontribuar së tepërmi në rilindjen e nacionalizmit brenda BE. Forca e kësaj tendence politike u shfaq dukshëm në maj të 2014-ës, kur populistët antieuropianë morën rezultate të kënaqshëm për ta në zgjedhjet për Parlamentin Europian. Që atëherë, tendenca nacionaliste ka vazhduar e pazbehur.

Nga një këndvështrim, kjo tingëllon e çuditshme. Në fund të fundit, asnjë prej problemeve që Europa has apo do të hasë në të ardhmen nuk mund të zgjidhet më lehtësisht vetëm, në nivel kombëtar, se sa brenda BE dhe përmes kuadrit të një komuniteti politik mbikombëtar. Në të vërtetë, ksenofobia nacionaliste është veçanërisht absurde po të kesh parasysh realitetet demografikë: Një Europë që plaket ka nevojë urgjente për më shumë imigrantë, jo më pak.

Gjithashtu është çuditshme se sa pak janë skandalizuar europianët kur kanë parë mbështetjen që nacionalistët e rinj dhe të vjetër të Europës kanë marrë nga Rusia; për shembull, qeveria e Vladimir Putinit dha një dorë për financimin e Frontit Nacional në Francë, përmes një huaje disa miliona Euro që u tërhoq në një bankë ruse. Me sa duket, pikëpamjet autoritare dhe këndvështrimi nacionalist për botën krijojnë gjithmonë lidhje të qëndrueshme.

Nuk është ekzagjerim të thuhet se aktualisht, BE është e rrezikuar prej nacionalizmit reaksionar, dhe kjo është arsyeja përse kriza e ardhshme e euros do të vijë në formën e një krize politike. Atëherë, përse autoritetet në Berlin, Bruksel dhe kryeqytete të tjerë të BE-së nuk janë ende të gatshëm të ndryshojnë politikat e tyre, të cilat është e qartë se e kanë përkeqësuar edhe më shumë situatën? Të shohësh BE nga jashtë është njësoj si të shohësh me xhirim të ngadaltë një tren që po shkon drejt përplasjes – një tren, që ishte paralajmëruar që në stacion.

Është edhe Britania e Madhe e cila po ecën në mënyrë të qëndrueshme dhe me vendosmëri të dukshme drejt “Brexit”-it. Ky rrezik shtrihet përtej 2015-ës; megjithëkëtë, është një komponent i rëndësishëm i panoramës së përgjithshme të krizës së BE-së. Pavarësisht nëse Mbretëria e Bashkuar do të ndahet apo jo politikisht prej kontinentit, viti i ardhshëm do të shënojë një pikë kthese për Europën. /Copyright: Project Syndicate. www.project-syndicate.org/



Sfidat gjeopolitike të vitit 2015

Analiza e çështjeve me kryesore që kanë shenjuar politikën ndërkombëtare të vitit që po lëmë pas, nga Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut, deri tek marrëdhëniet tejet e acaruar mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Rusisë

Viti që po lëmë pas, është karakterizuar në rrafshin gjeopolitik nga disa kriza ndërkombëtare të një rreziku të madh e që vetëm përmbledhtazi dhe duke harruar ndonjë syresh, mund t'i grupojmë në dy zona gjeografike, atë afrikano-veriore dhe Lindjen e Mesme, si dhe rajonin e Evropës Lindore.

Në rastin e parë, do të flasim për fundin e kurbës rritëse të Pranverave Arabe, e shenjuar mbi të gjitha nga zgjedhjet demokratike në Tunizi (e vetmja ngjarje pozitive), por edhe nga marrja e pushtetit nga ana e ushtarakëve në Egjipt, apo shpërbërja graduale e shoqërisë libiane, tek e cila rendja drejt të panjohurës dhe lufta shqetësojnë jo pak.

Tunizia dhe Egjipti

Tunizia, vendi nga i cili shpërthyen të gjitha pranverat arabe, arriti që të përfundo-

jë revolucionin e saj institucional, përmes miratimit të një kushtetute të re laike, ku u dëshmuua ndërkaq edhe një pjekuri mes votuesve islamikë dhe atyre që nuk janë të tillë. Për pasojë, sot vendi ka një parlament me një ekulibër të sanksionuar nga dy patitë kryesore, laikët e “Nidaa Tounes” dhe islamikët e “Ennahda”-as. Aftësia e këtyre forcave politike për të dialoguar, dhe konsensusi politik ishte mëse i dukshëm me zgjedhjen e Beji Caid Essebsi, një “figurë e njohur e viteve ‘90”, laik dhe me një reputacion të mirë edhe tek elitat e diplomacisë evropiane, e më së pari Francës.

Ndërkohë Egjipti reagoi me ashpërsi ndaj protestave në sheshe. Myslimanët qenë protagonistë të një sezoni të gjatë protestash, që kulmoi me fitoren e “Vëllazërisë Myslimane” në zgjedhjet e vitit 2012. Por ky sukses u shpërdorua, për shkak të menaxhimit të keq të pushtetit nga ana e presidentit Morsi, i zgjedhur nga rradhët e “Vëllazërisë Myslimane” me shpresa të mëdha, por që u dëshmuua shpejt si tejet i papërshtatshëm dhe i brishtë për detyrën që mori përsipër.

Për këtë arsye, pushteti i ushtarakëve u shndërrua në barrierën e vetme ndaj destabilitetit. Grushti i shtetit në Egjipt në korrik të vitit 2013, i realizuar gati sipas një manuali, çoi në presidencën e vendit Abdel Fattah Al Sisi-n, ish-gjeneral dhe aktualisht njeriu më i fortë në vend, i vetmi në gjendje për të garantuar rendin publik dhe stabilitet, sikurse dhe e demonstroi në fakt përgjatë gjithë vitit 2014. Shteti Islamik në Siri dhe Irak

Moderacionit të popullatave muyslimane që zgjodhën të emancipohen dhe distancohen nga radikalizmi fetar, iu kundërvu në Lindjen e Mesme një dukuri edhe më e rrezikshme, e përfaqësuar nga milicitë sunite të Shtetit Islamik të Sirisë dhe Irakut.

Oganizata xhiihadiste, e lindur nga vuajtjet e myslimanëve sunitë nën udhëheqjen e hekurt irakene shiite (duke zbatuar politikën e përjashtimit nga pushteti), sollin në skenë krahun e armatosur sunit që rrëmbeu armët dhe filloi luftën për pushtimin e Bagdadit, duke formuar celula të armatosura thuajse në gjithë veriun dhe lindjen e Irakut.

Prej qershorit të këtij viti e deri më tani, ISIS ka krijuar një boshllëk politik në Irak dhe është bërë pjesë e luftës civile në Siri, jo vetëm duke arritur që të imponohet nga ana ushtarake, në një pjesë të madhe të Mesopotamisë, por duke rikrijuar edhe një formë të organizimit shtetëror që ka origjinën nga shoqëria e lashtë arabe myslimane, Kalifati.

Një lëvizje kjo, që rrezikon të lërë në hije sukseset e borgjezive arabe, që arritën të emancipohen si pasojë e distancimit nga radikalizimi fetar, në një kohë që ISIS është dëshmuar i aftë, të tërheqë rreth vetes brezin e ri të myslimanëve që vijnë nga a gjithë bota, të gatshëm që të sakrifikojnë edhe jetën e tyre për Kalifin.

Një kauzë që megjithatë duket e pamjaftueshme, përse kohë përparimi i trupave të Shtetit Islamik është ndalur në vend, dhe në vitin 2015 nuk mundet veçse që të njohë rrudhje të mëtejshme, të mjaftohet vetëm me radikalizimin e zonave sunite të Irakut ose deri të rrëzikojë të shkojë drejt zhdukjes përfundimare.

Shumëçka do të varet nga fati, që ende mbetet pezull, i luftës civile në Siri (që tashmë ka kaluar vitin e katërt), dhe ku përveç veprimtarisë së trupave të ISIS, ndërthurren interesat e Moskës dhe Uashingtonit, që nga ana e tyre zhvillojnë një betejë që u jep më tepër frymëmarrje.

Ndërkohë sa për Izraelin dhe Palestinën, nuk ka shumë për të thënë as për vitin 2015, përse kohë rrezikohet të bihet në një ushtrim retorike, ku analizat politike të së tashmes, zëvendësojnë shpresa dhe propozime të mira, dhe kurrë fakte kyçe ose të reja për krijimin e ardhshëm të dy shteteve.

Ukraina nën morsën e Ruisë dhe SHBA

Kriza e ethme në Ukrainë gjatë vitit 2014, është në fakt pasqyrë e raporteve tejet të keqija, ku janë katandisur administratat aktuale në Uashington dhe Moskë. Mpakja e dialogut mes Ruisë dhe Shteteve të Bashkuara, ka rihapur arkivin e

marrëdhënieve historikisht problematike mes dy vendeve, duke të kujtuar epokën kur Muri i Berlinit ishte ende në këmbë. Në këto marrëdhënieve të akullta, është futur në mes edhe Kuba, e cila me fillimin e vitit të ri do të ketë marrëdhënieve normale diplomatike me Uashingtonin dhe kjo në kulmin e ftohjes mes Vladimir Putin dhe Barak Obamës. Një lëvizje kjo që i jep një pikë avantazh këtij të fundit, ndonëse në tërësi gjatë vitit 2014, presidenti rus është treguar lojtari më aktiv. Putin me të drejtë mund të përcaktohet si njeriu i vitit që po lëmë pas, pasi është dëshmuar se ka qenë i aftë për gjithçka: të afrojë Sirinë e Asadit me Perëndimin, duke ia dorëzuar këtij të fundit arsenalin e armëve kimike; zbuti Iranin duke e bindur t'i hapë rrugë bisedimeve për programin e tij bërthamor dhe arritjen e një marrëveshje me fuqitë botërore; aneksoi prej Ukrainës, gadishullin e Krimesë dhe mbrojtji pjesën lindore nga qeveria legjitime e Kievit.

Por 3-mujori i fundit ka nxjerrë në pah edhe shumë dobësi të Kremlinit: ekonomia energjitime dhe për pasojë ajo kombëtare, nuk po ecin me hapin e shpresuar. Rusia po kërkon partnerë strategjikë alternativë ndaj tregjeve të zakonshme. Ndërsa sanksionet ekonomike të vendosura nga Perëndimi, në përgjigje të trazirave në lindje të Ukrainës dhe rënia e cmimit të naftës, kanë rënduar më tej gjendjen, duke zhvlerësuar në mënyrë dramatike rublën dhe futur në krizë të thellë ekonominë kombëtare, një ngërç nga i cili do të duhen disa vjet për të dalë. Nga ky këndvështrim, mund të arrihet në përfundimin se Putin në vitin 2015, mund të zgjedhë një sjellje më të moderuar dhe një profil të ulët në arenën ndërkombëtare.

PERSPEKTIVA PËR VITIN 2015

Në tërësi 2014-ta ka qenë një vit kalimtar, drejt zgjidhjes së shumë çështjeve të koklavitura. Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut përshembull, mund të mundet përfundimisht përgjatë vitit të ardhshëm, ndërsa në qershor mund të ketë shanse reale për një marrëveshje mbi programin bërthamor të Iranit. Më e vështirë mbetet të parashikosh përfundimin e luftës civile në Siri, që në çdo rast qëndron në rendin e ditës, pasi të zgjidhet dilema e qëndrimit ose jo në pushtet të Bashar Asadit (çështje për të cilën do të duhet miratimi i Moskës).

Në rritje të plotë ekonomike, dhe me një president të lirë të veprojë edhe për 2 vitet e tij të fundit në pushtet, Shtetet e Bashkuara do të jenë gjilpëra e vërtetë e peshores, një fakt ky që bart edhe rreziqet e veta. Shtëpia e Bardhë, aktualisht po punon në prapaskenë për të forcuar oponencën e brendshme politike në Rusi, gjë që besohet se do të dobësojë më tej pozitat aktuale të presidentit Putin. Tentavita e rradhës për destabilizim synon të rrisë pushtetin e NATO-s në Evropë, por që nga ana tjetër mund të minojë përpjekjet për një zgjidhje paqësore të konfliktit në Ukrainë. Ndërkohë, nëse Vladimir Putin do të dëshmohej i kujdesshëm, do të arrijë që të çaktivizojë "bombën" e vendosur nën kolltukun e tij dhe me gjasë të pengojë që SHBA të vazhdojnë me strategjinë e saj që i ngjan aktualisht një seri të re të Luftës së Ftohtë, duke njohur nevojën për më tepër dialog mes palëve.

Në vitin 2015, kriza ekonomike në Evropë mund të ngadalësojë dhe vetë ekonomia italiane të rifillojë ngritjen. Shenjat e pagabueshme që viti 2014 ka lënë trashëgimi në Itali shihen në përgjithësi nga konstatimi se ngërçi ekonomik kafshon ende. Kryeministrit i takon detyra të angazhohet që vendi ynë të jetë një gadishull i progresit dhe stabilitetit, pa dëgjuar sirenat e disfatizmit por dhe duke shmangur kompromiset aspak parimore që kanë karakterizuar politikën italiane, duke e bërë atë të nevertishme dhe të pafuqishme për të ndërmarrë hapa pozitive për të ardhmen, sigurisht më të mire, që ky vend meriton./panorama.it/



GJEOPOLITIKE / Çfarë të mbajmë mend nga 2014-a?

PASCAL BONIFACE

Bilanci i vitit 2014 nuk është aspak ngazëllues. 2014 ishte një vit gjeopolitik shqetësues. Kemi patur më shumë lajme të këqia se sa dritë shprese. Konfliktet që u shfaqën në vitin 2014 do të duhet të menaxhohen në vitet e ardhshëm

Kriza ukrainase

Kriza ukrainase, si dhe përballja që e pasoi, midis Perëndimorëve dhe Rusisë, janë në mënyrë të pamohueshme pikat më shqetësuese të vitit që shkoi. Një ndryshim territorial i paligjshëm: u ndërhy në Evropë me aneksimin e njëanshëm të Krimesë nga qeveria ruse. Ky nuk është sigurisht ndryshimi i parë territorial në Evropë: pas një ndërhyrje ushtarake, Kosova fitoi pavarësinë e saj në vijim të një konflikti të armatosur, por ajo nuk u pushtua nga një fuqi e NATO-s. Sot jemi në një situatë e cila para së gjithash qëndron si një rezultat i luftës së ftohtë: Perëndimorët dhe rusët nuk kanë arritur të gjejnë mënyrën të mbajnë marrëdhënie të normalizuara.

Nuk do të mundet megjithatë të qëndrojmë përjetësisht në këtë situatë sepse Ukraina rrezikon të zhytet akoma më tepër në krizë dhe do të duhet që dikush të

rregullojë notën. Rusia dhe Perëndimorët janë në detyrimin të normalizojnë marrëdhëniet mes tyre, por në mënyrë paqësore dhe në barazi. Thelbësore është që Moskë të shihet si një partnere dhe jo si i munduri i luftës së ftohtë, dhe që ajo të ndërpresë privilegjimin e zgjidhjeve të forcës.

Konflikti izraelo-palestinez

Konflikti izraelo-palestinez nuk u qetësua gjatë vitit 2014, përkundrazi arriti kulmin me luftën në Rripin e Gazës gjatë kësaj vere, që popullsia civile palestineze e pagoi me çmim të lartë. Ky zjarr i ri ishte dështimi i rrugës së negociatës, sepse ne pamë që bisedimet diplomatike qysh prej vitit 2001, janë për qeverinë izraelite një mjet për të fituar kohë dhe të maskojë vullnetin e saj për të ruajtur mundësisht një pjesë sa më të madhe të territoreve palestineze.

Me të drejtë mund të pyesim nëse komuniteti ndërkombëtar do të vendosë më në fund të lëvizë. Sigurisht që kemi mundur të shohim një valë të njohjes së Palestinës, por derisa Shtetet e Bashkuara nuk do të lëvizin, izraelitët nuk do të ndryshojnë vijën e sjelljes. Ka gjasa që viti 2015 të jetë pesimist.

Mund të synohet që një qeveri izraelite më djathtas të dalë nga zgjedhjet legislative të marsit 2015. Në afat shkurtër, Izraeli nuk i trembet asgjëje, por kjo rrezikon të jetë mjaft e ndryshme në afat gjatë, për të cilën izraelitët – sigurisht për fat të keq pakicë – janë të ndërgjegjshëm.

Viti 2014 shënoi gjithashtu një pikë kulmore në mungesën e popullaritetit për Izraelin. Akoma dhe një herë Shteti Izraelit ka fituar luftën në planin ushtarak, por imazhi i tij në planin ndërkombëtar është përkeqësuar. Thirrjet e antisemitizmit për të shpjeguar degradimin e imazhit të Izraelit nuk përkraken: një divorc i vërtetë ndodhi midis opinionëve publike dhe qeverisë izraelite. Nëqoftëse qeveritë ende nuk janë ndarë nga kauza e tij, megjithatë dallojmë që mbështetja e tij pranë opinionëve publike po shkrin si bora në diell.

Shkallëzim i tensioneve midis Kinës dhe Japonisë

Gjatë vitit që kaloi patëm frikën e një shkallëzimi të tensioneve midis Kinës dhe Japonisë, nga përplasja e tyre për kontrollin e ishujve Senkaku. Në nëntor megjithatë mundëm të shohim një afrim të favorshëm midis dy palëve, në sajë të mbledhjes së Samitit të Bashkëpunimit Ekonomik të vëndeve të Azisë dhe Paqësorit (APEC), midis presidentit kinez dhe kryeministrit japonez. Kryeministri japonez duhet të bëjë kujdes që të mos i nxisë tensionet duke vazhduar projektin e tij të rishikimit të Kushtetutës japoneze dhe nenit të saj nr. 9, gjë që do të rrezikonte të krijonte një rreth vicioz dhe do të sillte rudhje të reja me Kinën, por gjithashtu me Korenë e Jugut.

Lulëzimi i organizatës të Shtetit islamik

Më në fund lulëzimi i organizatës të Shtetit islamik është në mënyrë të pamohueshme një nga pikat qëndrore të vitit 2014: u pagua çmimi i luftës së vitit 2003 kundër Irakut si dhe të luftës civile siriane. Megjithatë duhet të kujdesemi të mos ekzagjerojmë rrezikun që ky grup përfaqëson: ai është një kërcënim për popullsinë e rajonit, por nuk përfaqëson një rrezik aq të rëndësishëm për vendet perëndimore. Është e mira që të analizohet në mënyrë më gjakftohtë shtrirja e



Pesë rreziqet e ekonomisë botërore

Inflacioni i ulët, rreziqet gjeopolitike, mungesa e reformave strukturore. Por edhe rënia e BRIKS-it, fundi i likuiditetit në para dhe kohët e këqija që po kalon FED-i amerikan

Gjendja “shëndetësore” e ekonomisë botërore është kaq e brishtë, sa do të mjaftonte një përplasje e flatrave të një fluturë në Japoni, për të provokuar një tërmet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sesi do të jetë ekonomia e botës në vitin 2015, mund të shpjegohet edhe në këtë mënyrë, me të ashtuquajturin efekti “Flutur”. Gjatë 7 viteve që pasuan shpërthimin e flluckës në tregun e pasurive të patundshme në SHBA, dhe 6 vite pas fillimit të krizës në eurozonë, në sistemin financiar janë injektuar shuma të mëdha parash. Një akt ky pozitiv, në kushtet e një emergjence të jashtëzakonshme. Por një veprim negativ, nëse merren në konsideratë ç’ekuilibrimet e mundshme që sjell ky operacion. Ja cilat janë në mënyrë të përmbledhur 5 rreziqet e ekonomisë botërore.

Inflacioni tepër i ulët

Është skenari që tremb jo pak eurozonën, por jo vetëm. Edhe ekonomia botërore mund të ndjejë efektet e deflacionit, që ka prekur zonën e euros. Banka Qëndrore Evropiane ka ndërmarrë politika monetare të jashtëzakonshme, sikurse është edhe operacioni për rifinancimin në një periudhë afatgjatë të bankave të ndryshme, apo blerja e aksioneve të korporatave të mëdha sikurse janë “covered bond”. BQE, është shfaqur e gatshme edhe për blerjen e aksioneve të tjera sikurse janë edhe letrat me vlerë që emetojnë qeveritë e vendeve të bllokut. Gjithçka bëhet në emër të një objekti të qartë: që norma e inflacionit të jetë pranë një niveli të përbashkët, të përcaktuar nga “Eurotower”, që është 2 përqind. Si duhet të vepohet nëse edhe këto masa nuk japin efektet e pritura pozitive? Në fakt, mjetet që BQE ka në dispozicion janë ezauruar të gjitha, me përjashtim të blerjes së bonove qeveritare. Por të përdorësh edhe këtë kartë të fundit mund të rezultojë e kotë. Tek e fundit, rendimenti i tregjeve të tilla nuk ka qenë kurrë më i ulët që prej futjes në përdorim të euros e deri më sot. Dhe sa më tepër ulet norma e inflacionit, aq më tepër ekonomia tkurret. Stanjacioni, nga një gjendje paniku, mund të shndërrohet në normalitetin e ri për eurozonën, duke kontribuar në degradimin e mëtejshëm të ekonomisë botërore.

Greqia dhe rreziqe të tjera gjeopolitike

Në eurozonë nuk është vetëm Greqia, ajo që duhet mbajtur nën mbikëqyrje të rreptë. Vërtet Athina këto ditë tremb disi për shkak të zgjedhjeve të parakohshme presidenciale, të kërkuara nga vetë kryeministri Antonis Samaras, por vendi që duhet veprojë me kujdes në vitin 2015 është Italia. Në parim është e vërtetë që historia nuk bëhet me “nëse”, as edhe me “por”. Megjithatë, në mjedisin financiar sikurse dhe në atë politik, janë shtuar zërat që shohin tek viti 2015, erën e zgjedhjeve të reja parlamentare. Një skenar ky, që nga njëra anë mund të ngadalësojë procesin e ripërtëritjes, për të cilën vendi ka nevojë jetike dhe nga ana tjetër të frenojë shtytjen europeiste të qeverisë aktuale, duke i lënë më tepër hapësirë populizmit të Lega Nord-it apo “Lëvizjes së 5 Yjeve”. Këtij kuadri i duhen shtuar tensionet gjeopolitike që ende janë aktive. Frontet e betejës janë të mirënjohura: Lindja e Mesme dhe Rusia. Dhe sikurse ka rikujtuar “Stratfor”, në një raport të ditëve të fundit, “bota nuk ka qenë kurrë më pak e dobët dhe e pasigurtë sesa sot”.

Mungesa e reformave strukturore

Si kurrë më parë, Eurozona do të gjendet në vitin 2015 para një dileme të madhe: ose të ndërmarrë një reformë të plotë strukturore, që në fakt e pati premtuar në vitet e shkuara, ose investitorët do të humbasin edhe atë besim të vakët që kanë ende tek kontinenti i vjetër. Vëmendja është përqëndruar kryesisht tek Italia dhe Franca, të cilave Komisioni Evropian u ka lënë dorë të lirë për pak muaj, deri në mars të vitit të ardhshëm, kohë kur do të duhet të kenë gati masat që do të marrin, për të siguruar bilancet e tyre publike në vitet në vazhdim. Kjo kërkon një reformë të tregut të punës, sistemit të dretësisë, tregut financiar, racionalizimin e shpenzimeve publike dhe më shumë lehtësira në sistemin fiskal. Ndërsa ka mbaruar koha e kërkesave, ka ardhur momenti i përgjigjeve. Por meqenëse qeveritë duhet me të vërtetë të vënë në jetë ato që kanë premtuar, dhe rrezikojnë të humbin mbështetjen në popull, është e vëshiritë që t’i japin BQE-së ndihmesën që kjo e fundit po kërkon prej kohësh.

Rënia e BRIKS-it

Brazili, Rusia, India, Kina dhe Afrika e Jugut, kush më pak e kush më shumë, po tregojnë dobësitë e tyre. Ndonjë syresh si psh Brazili që po lodhet të gjejë dimensionin e tij industrial. Rusia po vuan çdo ditë e me tepër pasojat e sanksioneve të vendosura nga BE dhe SHBA dhe po shteron mjetet e saj të politikës monetare. Ndërkaq India, është e detyruar që të riformatojë të gjithë sistemin e saj financiar, duke përshtatur një model të ri tejet të kujdesshëm makroekonomik, që të rezultojë sa efikas ashtu edhe i qëndrueshëm. Kina ka në brendinë e vet një ç'ekulibilër të tillë financiar sa të vërë me shpatulla pas murit ekonominë botërore. Së fundmi, Afrika e Jugut po lufton kundër vetvetes, në përpjekje për të kryer hapin e madh, përta i përket lëndëve të para që nevojiten në industri. Vendet në zhvillim u shfaqën në skenën botërore dhe e bënë këtë në mënyrën më të keqe të mundshme, duke përshtatur gjëra për gjëra modelin e zhvillimit të ekonomive perëndimore, pa patur megjithatë asnjë paragjykim. Ngërçi që së fundmi po kalojnë ekonomitë e këtyre vendeve, mund të përkthehet si një rënie e kërkesës agregate në rang botëror, e aftë që të ndikojë si eurozonën ashtu edhe SHBA-në.

Mbarimi i rezervave në para nga FED-i amerikan

Në këtë vorbull kemi amerikanen Federal Reserve (banka qendrore). Pasi injektoi në sistemin financiar botëror miliarda e miliarda dollarë në 3 kohë të ndryshme përmes asaj që njihet si “quantitative easing” (mënyra përmes së cilës krijohen monedha nga Bankat Qendrore dhe injektohen përmes operacioneve në tregje të hapura si në sistemin financiar, ashtu edhe atë ekonomik), guvernatorja Xhenet Jellen vendosi që t'i rikthehet praktikës normale. Në 3-mujorin e fundit të këtij viti, Jellen ka urdhëruar tërheqjen e likuiditeve të krijuar nga QE dhe tashmë bota financiare, do të shohë shumë shpejt se cili do të jetë efekti i kësaj lëvizjeje. Sikurse sqaroi muaj më parë banka “Goldman Sachs”, “efektet e fundit të QE janë ende të papërcaktuara”. Nuk është pra e mundur, të bësh parashikime në një periudhë afatgjatë. Praktika e QE që rigjallëroi tregjet në Uoll Strit, la megjithatë një trashëgimi të rëndësishme, me gjasë të rrezikshme. Duke qenë se FED-i ka blerë në të shkuarën bono të qeverisë amerikane dhe letra të tjera me vlerë, “Mortgage-backed security” tituj që ishin garantuar së bashku nga garancitë hipotekore dhe që ishin në organizmin e vetë bankave, shkaktuan jo pak çregullime. Investitorët, bankat përfshirë, ende të tronditura nga falimentimi i “Lehman Brothers”, shkuan të kërkojnë fitime aty ku mundnin. Ishin pikërisht ato që privilegjuan grupin e kapitaleve, si bono qeveritare apo MBS-të, që nga ana e tyre mund të mbështeteshin tek garancia që jepte FED-i. Me këtë rast u krijuan fllucka të tjera, sikundër edhe ndodhi me tregun e garancive hipotekore të kredive të shtëpive. Pyetja që ngrenë investitorët është përherë e njëjta: a mundet që bankat qendrore të shmangin shpërthimin e papritur të krizave të tilla? /panorama.it/



Rusia, ose lojave e pasqyrave

Moska po përballet me krizën më të madhe ekonomike që prej vitit 1998. Me besimin e rrënuar tek sipërmarrësit, zhvlerësimin e rublës dhe goditjet e rënda prej saksioneve perëndimore pas krizës në Ukrainë, Kremlini po përpiqet që të rikthejë me çdo kusht normalitetin

Gjatë një konference të gjatë për shtyp në Moskë të premtën që shkoi, presidenti rus Vladimir Putin preku çështjen e statusit të tij, atë të një beqari ndër më të preferuarit nga gratë. I veshur me një kostum elegant dhe një kravatë ngjyrë vjollcë, presidenti shumëfyturësh dhe ish-agjenti i KGB-së garantoj dëgjuesit e tij se ai dashuron dikë dhe dikush e do atë. Pasi një javë kur monedha kombëtare rubla, u zhvlerësua sa hap e mbyll sytë brenda pak orësh dhe Banka Qëndore rriti ndjeshëm normën e interesit në mesnatë, zoti Putin dha përgjigje të mjegullta mbi vizionin që ai ka për ta nxjerrë Rusinë nga kriza më e rëndë ekonomike që ka goditur vendin prej vitit 1998. Ai paralajmëroi bashkëkombasit e tij që të përga-

titen për 2 vite të vështira ekonomike, duke shtuar se pas 15 vitesh në Kremlin, ai ka ndërmend të ndryshojë tërësisht ekonominë ruse, duke shmangur varësinë e madhe nga energjia, mineralet apo industria ushtarake. Por zoti Putin nuk tha asnjë detaj sesi kjo do të ndodhë, duke shtuar vetëm se mbetet krenar dhe sfidues dhe pretenduar se problemet ekonomike të vendit vijnë pjesërisht nga sanksionet e vendosura nga SHBA dhe BE, si dhe duke ia faturuar krizën ekonomike situatës në Ukrainë dhe NATO-s, që sipas tij po rreket sërish ta çjerrë ariun rus.

“Disa herë, mendoj se do të ishte më mirë për ariun tonë të ulet dhe të rrijë i qetë në punën e vet, me tepër sesa të sorrollatet nëpër pyll pas gjurmëve të derrit. Më mirë të ushqehet me manaferra dhe mjaltë. Ndoshta vetëm atëherë do ta lënë të qetë”- deklaroi zoti Putin. “Por kjo nuk ka për të ndodhur, sepse ata përherë do të përpiqen që t’a kapin dhe mbyllin ariun në kafaz, sikurse bënë në fakt para disa vitesh, duke e kapur me zor për dhëmbësh apo nga putrat”.

Prapa imazhit të gjallë të pyllit Siberian, gjendja shpirtërore e njerëzve të Putinit është e trazuar. Zhvlerësimi i rublës çoi në konstatimin e realitetit të zymtë që ekziston në administratën e tij.

“Ministri i Financave po llogariste se cila normë shkëmbimi valutë për rublën, mund të nxjerrë buxhetin nga pika kritike. Ne filluam të hamendësojmë se cila normë e rublës, mund të ishte një formulë magjike që do të shënonte fundin e epokës së Vladimir Vladimirovich Putinit”- thotë një anëtar i familjes së një prej njerëzve më të ngushtë të presidentit.

“Nuk ka më kohë. Duhet të veprojmë dhe ta bëjmë këtë në mënyrë radikale” – deklaroi Vladimir Milov, ish-Ministër i Energjisë, tashmë në opozitë me qeverinë, duke paralajmëruar se Rusia është mbërthyer nga një krizë e thellë e likuiditetit dhe borxheve, një krizë e buxhetit si dhe e besimit të investitorëve. “Nga pikëpamja politike, ndryshimi i qeverisë dhe drejtimit të Bankës Qëndrore, nuk do t’i ndihnte aspak daljes nga situata aktuale, pasi sipas tij kriza e trefishtë është pasojë e një njeriut të vetëm, presidentit aktual Putin”- shkruan ai në një blog në internet. “Dorëheqja e Putinit është e domosdoshme për tejkalimin e kësaj krize, sepse pas 15 vitësh në pushtet, besimi tek ai ka humbur tërësisht”.

Përveç zotit Milov dhe pak mendjeve të pavarura liberale që i janë kundërvënë publikisht zotit Putin, pak vetë në Rusi besojnë se kriza e rublës do ta largojë nga pushteti presidentin rus. “Nuk ekziston asnjë opozitë e qenësishme. Zoti Putin në këtë drejtim ka kryer një punë të shkëlqyer”- thotë një ish-zyrtar i Kremlinit. “Tashmë çështja kryesore është sesi ai do të përdorë presidencën, për të na kthyer në normalitet”.

“Normalitet” nuk është një frazë që gjendet kollaj në gojën e mijëra rusëve, që vërshuan këtë javë nëpër banka për t’i kthyer kursimet e tyre në dollarë dhe euro, në vend të një ruble që luhet në mënyrë të paparashikueshme. Në një moment kritik të martën, rubla u zhvlerësua me 36 përqind dhe gjendja shpirtërore në rrugë evoluoi nga një shqetësim i kuptueshëm në një gjendje të plotë paniku. Një nga degët e njërës prej bankave kryesore të Moskës “Sber- bank”, huadhënësi më i madh në Rusi, tregon për “Financial Times” se në orën 7 pasdite, pati në arkat e saj vetëm 100 dollarë, në një kohë që e pati nisur ditën me 100 mijë dollarë.

Gremisja e rublës

Rusët e tjerë, duke patur frikë se humbën shansin për të kthyer kursimet e tyre në dollarë, sipas një kursi të leverdishëm, e shpenzuan rublën duke blerë mallra. Dyqanet e elektroshtëpiakeve u zbrazën brenda natës, ndërsa e njëjta gjë ndodhi edhe me pikat e gjigandit botëror të mobilierisë “Ikea” pas shpalljes së uljeve të mëdha. Megjithatë luhata e rublës ishte aq e madhe sa kompanitë mbyllën pikat e shitjeve on-line, për të rillogaritur çmimet e produkteve.

“Kur ju vrëreni që njerëzit derdhen nëpër banka, kjo do të thotë se vendi gjendet në ditën e tij më të keqe”- shprehet Oleg Kouzmin, një ish-zyrtar i lartë i Bankës Qëndrore, që tani punon si ekonomist në bankën e investimeve “Renaissance

Capital”.

Shenjat për gremisjen e rublës ishin shfaqur që prej disa muajsh. Ato ishin rënia e ndjeshme e çmimit të naftës që përbën eksportin kryesor të Rusisë, sanksionet e vendeve perëndimore që ia bënë shumë të vështirë kompanive ruse rifinancimin e borxhit të tyre të brendshëm, si dhe një humbje e thellë e besimit në perspektivën e ekonomisë ruse, duke bërë që sipërmarrjet, veçanërisht ato të huaja të pezullonin investimet e parashikuara.

Problemet e mëdha me zbatimin e shtetit ligjor, korrupsionin dhe mbrojtjen e pronës private, kanë shkaktuar largimin e kapitalit të huaj gjetiu. Sipas të dhënave të Bankës Qëndrore në Moskë, kapitali që është larguar nga vendi pritet të dyfishohet këtë vit në 134 miliardë dollarë. Rënia e sigurtë ekonomike dhe mundësia e zhvlerësimit të mëtejshëm të monedhës kombëtare, sugjerojnë se kjo tendencë do të vazhdojë me të njëjtin ritëm edhe në vitin 2015. Pak interes ka patur edhe ndaj ofertës së zotit Putin, në fillim të këtij muaji, për të falur plotësisht të gjithë ata sipërmarrës rusë që rikthejnë në vend kapitalet e tyre.

Rubla e cila filloi që të forcohet disi të mërkurën, ishte sërish në pikën më të ulët në fund të kësaj jave me 2 përqind me dobët sesa kishte nisur java. Por pasojat e së martës mbeten ende të rënda. Zoti Putin fajësoi drejtuesen e Bankës Qëndrore, Elvira Nabiullina, se nuk ndërhyri në kohë për të mbështetur rublën. Një hap në drejtimin e duhur do të ishte një shitje e rezervave të mëdha, që Rusia ka në valutë të huaj. Por instikti rebel i zotit Putin e kundërshtoi edhe këtë masë. Njëra nga arritjet më të mëdha të presidentit rus, ishte shlyerja e borxhit të jashtëm rus dhe akumulimi i qindra miliardë dollarëve në rezerva-një provë kjo konkrete në vetëmburrjen e tij se Rusia rifitoi sovranitetin e saj, pas krizës së rëndë të borxheve të vitit 1998.

Gishti i fajit ra edhe mbi Igor Sechinin, njëri nga njerëzit më të besuar të presidenti Putin dhe shefi i “Rosneft-it”, kompania më e madhe shtetërore e naftës, që ka qenë edhe shënjestra kryesore e sanksioneve perëndimore. Rosneft-i shiti bono në vlerën e 625 miliardë rublave, përpara maturimit të borxhit që ka në dollarë tek bankat e huaja. Banka Qëndrore lejoi autoritet që të shërbejnë si garanci për injektimin e 700 miliardë rublave për bankat ruse. Në fakt, Rosneft mbuloi nevojën për rifinancimin, duke marrë direkt hua nga Banka Qëndrore dhe vendosur kështu rublën nën presion. Zoti Putin ishte duke përgatitur një darkë me biznesmenet më të pasur të vendit për të diskutuar mbi këtë situatë.

Dëmet nga sanksionet

Nëse shumëkush duhet të fajësohet për gremisjen e rublës, pak persona bëjnë përgjegjës guvernatoren Nabiullina. Alexei Kudrin, një ish-ministër finance që gëzon respekt në opinionin publik, deklaroi në profilin e tij në “Twitter” se marrëveshja e Rosneft, ishte kryer në momentin më të keq të mundshëm. I pyetur se si do të vepronte në vend të zonjës Nabiullina, Viktor Gerashenko, një ish-guvernator i Bankës Qëndrore përgjigjet: “Unë do të gjeja një pistoletë dhe do të vrisja veten”.

Më shumë sesa rritja e çmimit të naftës, ekonomia ruse duhet që të shpresojë në heqjen e shpejtë të sanksioneve nga Perëndimi. Sipas Timothy Ash, shefi i tregjeve financiare në “Standard Bank”, “sanksionet perëndimore gradualisht kanë reduktuar likuiditetin në dollarë, duke e vendosur ekonominë ruse nën një morskë të mirëfilltë.

Por sikurse liderët e SHBA dhe BE kanë bërë të qartë javën që lamë pas, sanksionet nuk do të hiqen deri kur Rusia t’i japë fund destabilizimit të Ukrainës, përmes mbështetjes ushtarake të separatistëve në rajonin juglindor të Donbass-it. Disa besojnë se që prej kësaj jave Rusia po e rimendon sjelljen e saj. Ministri i Jashtëm, Sergei Lavrov, tha se Rusia nuk do të këmbëngulë mbi “federalizimin” e Ukrainës, duke u tërhequr kështu nga njëra prej kërkesave kryesore të Moskës për zgjidhjen e krizës.

Nga ana e tij zoti Putin gjatë konferencës së tij për shtyp, iu referua rajonit të shumëdiskutuar si “Ukraina Lindore” (në vend të “Novorossiya” “Rusia e Re”), një shprehje kjo gjeopolitike që në kohërat e carëve dhe të cilën ai e pati përdorur më herët përgjatë këtij viti, në një mënyrë që Rusia kishte ndërmend të aneksonte një territor të gjerë ukrainas nga Donjecku në Odesë.

Ndërkohë, në terren ka pak shenja se rebelët pro-rusë dhe trupat ukrainase do të vendosin brenda dimrit një armëpushim afagjatë. Ndërsa mbetet e paqartë sesi zoti Putin mund të bëjë lëshime ndaj Ukrainës, në një masë të tillë sa të kënaqë qeveritë perëndimore, pa dëmtuar presidencën e tij. Që prej shtypjes së protesave të mëdha demokratike të opozitës në Moskë në dhjetor të vitit 2011, dhe veçanërisht që prej revolucionit të muajit shkurt në Kiev, aparati shtetëror i presidentit Putin ka përdorur tone të forta nacionaliste, që lënë pak hapësirë për të qenë fleksibël. Shkarkimi i shumëpërfolur i kryeministrit Dmitry Medvedev, mund të ishte një shenjë pozitive, nëse ky i fundit do të zëvendësohej nga zoti Kudrin apo ndonjë tjetër me të njëjtin reputacion për menaxhimin e kujdesshëm të financave të vendit dhe që kupton mirë rolin e ekonomisë ruse në botë. Por do të kishte pak shpresë, nëse kryeministri i ri do të jetë Dmitry Rogozin, një tjetër i besuar i Putinit dhe një drejtues i linjës së ashpër i industrisë ushtarake ruse. “Nëse do të kishin Rogozin në krye te qeverisë, kjo do të sillte më shumë retorikë armiqësore ndaj perëndimit, më shumë para për mbrojtjen dhe një ekonomi më e mbyllur. Ndërsa nëse do të kishim Kudrin, kjo do të dëshmonte një sinjal për hapje, kompromis dhe reforma”- deklaroi një diplomat evropian në Moskë. “Fakti që lavjerrësi lëkundet mes këtyre të dyve, të çon në përfundimin se zoti Putin është i gatshëm që të shfrytëzojë çdo mundësi që i ofron shanse më të mira për të çimentuar qëndrimin e tij pushtet”./Financial Times/



A është ky fundi Luftës së Ftohtë në Amerikë?

JEAN-JACQUES KOURLIANDSKY

A është një surprizë kjo etapë e re e afrimit mes Kubës dhe Amerikës? Ky vendim është me të vërtetë një surprizë sepse askush nuk e priste që marrëdhëniet midis Shteteve të Bashkuara dhe Kubës, të ndërprera qysh prej vitit 1962, të vendoseshin të mërkurën më 17 dhjetor 2014. Para disa ditëve, një bankë gjermane “Commerzbank”, u paraqit përpara drejtësisë amerikane – në të njëjtat kushte si banka franceze BNP disa muaj më parë – sepse ajo ishte akuzuar se nuk kishte respektuar embargon e njëanshme të vendosur nga Uashingtoni mbi Kubën. Ky njoftim pra bëri efektin e një bombe sepse nëse do të mund të vëzhgojm një numër elementësh të favorshëm, askush nuk e priste t’i shikonim ato të konvergonin për të arritur në një rezultat të tillë. Dihej në fakt që kontaktet ishin lidhur midis dy vendeve qysh prej vitesh dhe se Shtetet e Bashkuara dispononin një ambasadë jo zyrtare – e vendosur nën autoritetin e Zvicrës për arsye të së drejtës – në Kubë. Dihej gjithashtu se ekzistonin marrëdhënie ekonomike mjaft të rëndësishme midis dy vendeve, sidomos në fushën e bujqësisë. Përveç kësaj, amerikanët me origjinë kubaneze kishin fituar të drejtën të shkojnë në Kubë. Dek-

larata e Sekretarit amerikan të Shtetit, John Kerry, i cili kishte përgëzuar Kubën për rolin e saj motorr në luftën kundër virusit të Ebolës, ishte interpretuar gjithashtu si një sinjal i favorshëm. Në vijim u mësua se të dy vendet kishin krijuar një grup pune, që dialogonte në mënyrë të përhershme qysh prej një viti, dhe se negociatat ishin mbajtur në sekretin më të madh në Kanada me mbështetjen e qeverisë kanadeze si dhe të Selisë së Shenjtë. Bisedimet sigurisht u realizuan në fshehtësinë më të madhe, gjë që shpjegon surprizën e shkaktuar nga njoftimi. Çfarë impakti do të mund të ketë ky afrim midis Shteteve të Bashkuara dhe Kubës, dhe në veçanti për qytetarët kubanezë?

Pasoja e parë e këtij afrimi – e kërkuar në mënyrë aktive nga autoritetet kubaneze – do të jetë njohja nga Shtetet e Bashkuara e specifikimit kubanez, me shëmbëlltërinë e përçapjes që ato kanë adoptuar vis-à-vis Kinës apo Vietnamit. Autoritetet kubaneze mendojnë që kjo marrëdhënie të jetë bazuar në respektimin e ndërsjelltë të diferencave (zgjedhja ekonomike, modeli social, etj.): nëse do të dëshironim të përdorej një term që i referohet luftës së ftohtë, do të mund të flisnim për “bashkëekzistencë paqësore në ndryshimet tona”. Në mënyrë më anekdotike, tre kubanezë – të dënuar nga drejtësia kubaneze për spiunazh por të konsideruar si heronj të revolucionit kubanez – u liruan nga Shtetet e Bashkuara dhe u shkëmbyen me dy shtetas amerikano-veriorë, të burgosur për spiunazh në Kubë. Mbrapa të gjitha këtyre elementëve, objektivi madhor i autoriteteve kubaneze është ndihma ekonomike dhe përfitimet e rëndësishme financiare që do të sjellë ky normalizim i marrëdhënieve me fqinjën e pasur amerikan. Një heqje e plotë e kufizimeve në lëvizjen e qytetarëve amerikanë drejt Kubës do të ndodhte kështu. Për qytetarët amerikanë pa origjinë kubaneze do të jetë e mundur të shkojnë për vizitë në Kubë. Kuba shpreson të ribëhet kështu siç ishte në fillim të shekullit XX, para revolucionit, pra një vend pushimesh tropikale, (vetëm 150 km larg nga brigjet amerikane), relativisht me një çmim të lirë. Ky afrim do t'i krijojë të ardhura në valutë shtetit kubanez, ekonomia e të cilit mbështetet në pjesën më të madhe në turizmin ashtu si dhe në një numër ishujsh fqinj.

A shënoi kjo ngjarje fundin e luftës së ftohtë në kontinentin amerikan ?

Siç e pranoi Obama, do të ishte absurde të mbahej një vijë politike vis-à-vis Kubës që daton me luftën e ftohtë ndërkohë që armiku kryesor i Shteteve të Bashkuara, Bashkimi Sovjetik ishte zhdukur qysh prej më shumë se dy dekadash dhe se Shtetet e Bashkuara kanë marrëdhënie normale me ish vendet e bllokut të lindjes, Kinën dhe Vietnamin. Armiku numër 1 i Shteteve të Bashkuara nuk është sot Kuba, por organizata e Shtetit Islamik. Të mbaje një embargo të tillë dhe një politikë të tillë ishte pra një gabim që qëndronte në elementë të politikës së brendshme në Shtetet e Bashkuara dhe nuk ishte pra një vendim racional. Ky ishte sidomos rasti i vendeve të Amerikës Latine, të cilët e kanë përfshirë Kubën qysh prej shumë kohësh në lojën rajonale dhe kanë vendosur marrëdhëniet e tyre diplomatike. Vendet amerikano-latine kanë krijuar struktura paralele në Organizatën e Shteteve Amerikane – nga e cila Kuba ishte përjashtuar deri në vitin 2009 para se një votë e shteteve anëtare t'i jepte asaj të drejtën për ta integruar përsëri kur ajo e mendonte – për ta integruar Kubën edhe në Komunitetin e shteteve latino-amerikane dhe karibeve (CELAC), Unionin e kombeve jug-amerikane (UNASUR), si shtet i ftuar dhe Aleancën boliviane për Amerikat (ALBA). Në Kubë u mbajtën negociatat e paqes midis FARC dhe qeverisë kolumbiane. Në vitet '90, Kuba gjithashtu ka luajtur një rol motorr në rregullimin e konflikteve në Amerikën qendrore, të trashëguara nga lufta e ftohtë. Për latino-amerikanët, lufta e ftohtë kishte përfunduar qysh prej shumë kohësh në Amerikën latine, ndërkohë që deri dje nuk ishte për autoritetet amerikane. Mirëpo një politikë e tillë nuk ishte e pakuptueshme nga shtetet e tjera latino-amerikane, që kritikonin linjën e mbrojtur nga Shtetet e Bashkuara. Ky normalizim i marrëdhënieve me Kubën do ta nxjerrë gjithashtu Barack Obaman nga një situatë diplomatike mjaft

e komplikuar. Në fakt Panamaja ka parashikuar të priste samitin e ardhshëm të Amerikave në vitin 2015, në të cilën ishte ftuar gjithashtu dhe Kuba. Situata ishte shumë komplekse sepse presidenti amerikan duhej t'i bënte ballë dy opsioneve që paraqesin të dyja komplikime: Barack Obama do të mund kështu ose të vendosë të bojkotojë samitin – por një vendim i tillë do ta vendosë atë në një gjëndje të pa sigurt vis-à-vis Panamasë, një nga aleatët më besnikë të Shteteve të Bashkuara – ose do t'i duhet të marrë përsipër rrezikun të takojë presidentin kubanez.

Cilat janë motivet që e shtynë Barack Obaman të normalizojë marrëdhëniet e Shteteve të Bashkuara me Kubën?

Kubanezët duke qenë të gatshëm qysh prej një kohe të gjatë për një afrim të tillë, është e ligjshme të pyesin përse presidenti amerikan vendosi të mirrte një vendim të tillë sot dhe jo më parë. Për mendimin tim është e nevojshme të përfshihet një dimension i politikës së brendshme në Shtetet e Bashkuara në ekuacion dhe të shohim këtu një pasojë të humbjes së kampit demokrat gjatë zgjedhjeve në mes të mandatit – dy vite para zgjedhjeve të ardhshme presidenciale. Menjëherë pas zgjedhjeve, Barack Obama kaloi në sulm duke trajtuar shumë dosje të ndjeshme siç është zyrtarizimi i miliona imigrantëve pa dokumenta, që është me të vërtetë një përfaqje e re e politikës së imigracionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, apo dënimin e qëndrimit të policëve bashkiakë vis-à-vis komuniteteve afro-amerikane për të nisur ripushtimin e opinionit publik amerikan dhe për të shënuar qartazi diferencat midis partisë së tij dhe partisë republikane. Obama vendosi këtë herë t'i shtrijë dorën komunitetit kubano-amerikan. Me gjeste të tilla ai mendon t'i detyrojë Republikanët të hyjnë në një betejë politike, që ka gjasa të jenë premisat e fushatës për zgjedhjet presidenciale të vitit 2016.



Hegjemoni vetmitar dhe ngurrues i Europës

MARTIN WOLF

Gjermania është një hegjemion ngurues. Është kaq e thjeshtë për ta kuptuar këtë. Por është gjithashtu shumë e fuqishme dhe shumë qendrore për të shmangur fatin e saj të ri. Mbetet e ardhmja e një Europe politike dhe ekonomike mjaft delikate. Koha për të menduar ngushtë ka kaluar. Gjermania, tashmë është një vend i madh me përgjegjësi të shumta, dhe do të gjykohet nga ajo sesi do të dijë t'i trajtojë këto përgjegjësi

Këtë vit përkujtuam 100-vjetorin e fillimit të Luftës së Parë Botërore dhe 25-vjetorin e rënies së Murit të Berlinit. E para çoi drejt një katastrofe edhe më të madhe, që ishte Lufta e Dytë Botërore, e pasuar nga ndarja e Europës në dy pjesë: mes perëndimit dhe bllokut komunist. E dyta shënoi fundin e asaj ndarjeje dhe shtroi nevojën për një Europë të lirë dhe të bashkuar. Sot ne konstatojmë një

ironi të madhe të historisë: Gjermania fitoi përmes paqes, atë që mendoj se do të mund të fitonte përmes luftës. Për mirë apo keq, Republika Federale është aktualisht qendra e pushtetit europian. Disa lindin të mëdhenj, të tjerë e fitojnë madhësitë rrugës, ndërsa disa të tjerë e kanë të shenjuar madhësitë mbi krye. Gjermania tashmë po përjeton stadin e fundit në formën e saj më të plotë. Por si po e menaxhon ajo këtë përparësi ?

Në tërësi mjaft mirë, ndonëse jo mjaftueshëm. Epërsia gjermane nuk është thjesht një çështje e madhësisë së saj hapësinore apo e pozicionit gjeografik. Nuk është as edhe produkt i zhvillimit të saj industrial. Njëri prej vendeve më të mëdhenj europianë, Gjermania ka arritur që të ketë një demokraci të pjekur dhe të qëndrueshme. Është e çliruar nga populizmat ksenofobë që trazojnë fqinjët. Kancelarja aktuale Merkel zotëron pjekurinë e jashtëzakonshme të një lideri të përgjegjshëm.

Përtej këtyre fitoreve, jo gjithçka shkon vaj. Ekonomia e eurozonës ka ngecur në llumin e stagflacionit, si edhe të inflacionit në nivele minimalë. Shumë politikëbërës në Gjermani i rezistojnë ende tundimit për të ndërmarrë masa që do të ndryshonin këtë situatë. Për pasojë, projekti European që dikur vetëmburrej me forcën dhe enegjinë e tij pozitive, paraqet tashmë jo një shpresë për një jetë më të mirë, por e kundërta. Ndërkohë, në lindje një Rusi revanshiste ka arritur që të destabilizojë një Ukrainë harmonike dhe kërcënon të bëjë të njëjtën gjë edhe me vendet që dikur ka qenë pjesë e perandorisë sovjetike. Sërish si në rastin e ekonomisë, kjo sfidon refleksët e Gjermanisë së pasluftës. Berlioni dëshiron që të shmangë pozicionet edhe më agresivë ndaj Rusisë, por e di se nuk mund të vazhdojë gjatë në këtë mënyrë. Vështirësia që has Gjermania në gjetjen e një roli të ri është e kuptueshme.

Gjermania nuk e kërkoi monedhën e përbashkët euro. Përkundrazi, ishte çmimi që të tjerët i kërkuan të paguajë për të farkëtuar bashkimin. Politikëbërësit gjermanë i kuptojnë fare mirë ndërlikimet politike dhe ekonomike të një bashkimi monetar. Vështirësi që pothuasje shumica e anëtarëve të tjerë nuk i kuptuan. Përtej kësaj, Gjermania ka përballë një problem të madh: doktrina ekonomike që solli bumin e madh ekonomik të pasluftës, nuk mund të aplikohet e pandryshuar në një zonë të madhe dhe të larmishme, sikurse është ekonomia e eurozonës. Ajo është e detyruar të arrijë në disa kompromise që në fakt i cilëson si dështime. Doktrina kryesore e gjermanëve bazohet në një ekonomi të vogël dhe të hapur. Kjo është e vërtetë edhe për gjeopolitikën e saj. Sipas kësaj doktrine, përgjegjësia për sigurinë globale u mbetet të tjerëve: SHBA mbi të gjitha, së bashku me Europën, por me në krye Francën dhe Britaninë e Madhe.

Në të dyja rastet, perspektiva e “vendeve të vogla” ishte e natyrshme por në të vërtetë e imponuar nga katastrofa që pësoi Gjermania në tentativën e saj për të ftuar madhësitë. Por këto reflekse nuk janë më të përshtashme, pasi ato kanë lënë një boshllëk që vetëm Gjermania mund ta mbushë. Pikësëpari përse i përket eurozonës, ajo që duhet bërë si fillim është ta shohësh atë si një ekonomi të vetme. Çfarë shohim ne aty? Prej disa vitesh, inflacioni vjetor është vetëm 0.7 përqind. Në 3-mujorin e dytë të këtij viti, kërkesa nominale e brendshme ishte 1.7 përqind më e madhe sesa piku i para-krizës, ndërsa kërkesa reale ishte 5 përqind më e ulët. Papunësia është në nivelin e 11.5 përqind të krahut të punës. Çfarë tregon kjo? Thjesht që Banka Qëndrore Europiane ka dështuar në detyrat e saj.

Në një nga fjalimet e tij të fundit, Jens Weidmann, Presidenti i Bankës Qëndrore Gjermane iu përgjigj kësaj situatë duke argumentuar se “është fantastike të besosh se politikat monetare mundet që të garantojnë potencialin e nevojshëm që shtyn përpara rritjen ekonomike”. Ai ka të drejtë. Por politika monetare duhet që të garantojë se ky potencial do të shfrytëzohet. Sigurisht që kjo është shumë e vështirë në një zonë me një monedhë të vetme dhe me kundërshti të mëdha në kuadër të një konkurrence të brendshme. Por kjo thjesht nënvizon një tjetër fakt:

beteja për konkurrencë në kushtet e një eurozone që ka reduktuar ndjeshëm pagat, nuk është një shteg që të çon medeomos drejt zhvillimit. Përkundrazi është një lojë më rezultat zero. Në rast se Gjermania kërkon që të jetë një hegjemone e suksesshme, atëherë duhet të hedhë vështrimin më larg. Duhet që të rikujtojë se edhe çështjet e brendshme, kanë rëndësinë e tyre.

Në Gjermani ekziston një opinion i gjithëpranuar se pa pasojat e krizës, nuk do të ishte ndërmarrë asnjë reformë. Këtu ka diçka të vërtetë. Por ka gjithashtu edhe diçka tjetër: vendet në krizë mund të zgjedhin qeveri që refuzojnë politikat e arsyeshme e të drejtpërdrejta. Kjo do të ishte një tragjedi e madhe për të ardhmen e Europës. “Jep ilaçin sipas dhimbjeve” – mbetet një parullë e ditës, kur ke të bësh me krizat. Çfarë do të thotë kjo në kushtet aktuale? Do të thotë se Gjermania kishte të drejtë kur mbështeti Mario Dragin në përpjekjen e tij për të eliminuar riskun e një shkërmoqjeje të plotë ekonomike në vitin 2012. Por tani ajo duhet të mbështesë sërish presidentin e BQE-së, në tentativën e tij për të nxitur kërkesën dhe shmangur deflacionin.

Do të thotë gjithashtu që si një vend kreditues, ajo duhet që të pranojë më shumë përgjegjësi mbi shpatulla përsa i përket menaxhimit të financave të unionit. Ristrukturimi i borxhit duhet të jetë në tryezën e bisedimeve, duke filluar me Greqinë. Irlanda gjithashtu duhet që të çlirohet nga ngarkesa e rëndë e të dalit garant ndaj kreditorëve të huaj mendjehetë, që kanë derdhur paratë e tyre në bankat e saj problematike. Së fundmi por jo më pak e rëndësishmja, Gjermania duhet të ndajë përgjegjësinë mbi reformat makroekonomike që do të duhet të ndërmerren pas krizës financiare. Një hegjemon i zgjuar vetiu do të pyesë: Si sjellja ime mund të përcaktojë qëndrueshmërinë dhe suksesin e sistemit nga i cili përfitoj edhe unë dhe për të cilën jam shumë i përgjegjshëm? Kjo pyetje qëndron si në rafshin ekonomik, ashtu edhe atë gjeopolitik. Është barra e Gjermanisë që së bashku me aleatët t’i japë një përgjigje të fortë Ruisë së Vladimir Putinit, duke kombinuar me shkathtësi karotën e përfitimeve të ndërsjellta, me shkopin gati në duar për të parandaluar më të keqen. Kjo do të kërkojë nga Gjermania të marrë një pozicion agresiv në mbrojtje të vlerave perëndimore.

Gjermania është një hegjemion ngurues. Është kaq e thjeshtë për ta kuptuar këtë. Por është gjithashtu shumë e fuqishme dhe shumë qendrore për të shmangur fatin e saj të ri. Mbetet e ardhmja e një Europe politike dhe ekonomike mjaft delikate. Koha për të menduar ngushtë ka kaluar. Gjermania, tashmë është një vend i madh me përgjegjësi të shumta, dhe do të gjykohet nga ajo sesi do të dijë t’i trajtojë këto përgjegjësi./Financial Times/



Nga Islami tek diktatori i kuq: Liria jonë në rrezik

Rritet numri i filmave dhe serialeve televizive që e pësojnë nga censura. Pas filmit komik “The Interview”, edhe “Homeland” dhe “Exodus” bie pre e ndalimeve

Dikujt alarmi mund t’i duket i ekzagjeruar, por censurimi i filmave, çështje për të cilën flitet prej ditësh, të risjell në kujtesë djegien e librave të autorëve hebrej, gjatë diktaturës naziste. Ngjarja më e madhe e këtij lloji, ndodhi në Berlin në 10 maj të vitit 1933.

Atë natë, iu vu flaka mijëra vepraveve të cilësuar se ishin “kundër shpirtit gjerman”. Në të njëjtën ditë, Gëbelsi do të mbante një fjalim të zjarrtë, ku ndër të tjera do të deklaronte se djegia e librave ishte një mënyrë shumë e mirë “për të zhdukur, përmes flakëve, shpirtin e lig të së shkuarës”.

Sot në epokën e internetit, të djegësh një libër apo të ndalosh një film, nuk ka të njëjtën rëndësi. Megjithatë ekzistojnë forma gjithnjë e më të rafinuara, e herë-herës të rrezikshme, për të penguar lirinë e mendimit. Në thelb të gjithçkaje është si gjithmonë censura.

Rasti më flagrant, është ai i ditëve të fundit me komedinë amerikane “The Inter-

view” (Intervista), filmi parodi që ka tërbuar Korenë e Veriut dhe vrerosur regjimin e Pyongyang-ut dhe hakerave koreano-veriorë, kundër kompanisë Soni, që prodhoi filmin.

Filmi bën fjalë për dy gazetarë amerikanë, që gjatë tentativave të njëpasnjëshme, për të intervistuar Kim Jong Un-in, un rektrutuan nga CIA që iu beson atyre një mision sekret: të vrasin diktatorin!

Pas kërcënimeve të marra (njëri prej tyre: Do të shkaktojmë një 11 Shtator të ri!), filmi nuk doli në kinema. Vetëm pas presioneve të forta nga Shtëpia e Bardhë, e vendosur që të dekurajojë çdo lloj forme të çensurës në territorin e saj, filmi u vendos që të shfaqej në vetëm 300 salla kinemaje (nga 3 mijë të planifikuara), ditën e Krishtlindjeve.

Javët e fundit janë regjistruar raste të tjera flagrante të “çensurës”, kundër prodhimeve të ndryshme kinematografike. Egjipti dhe Maroku psh. kanë ndaluar shfaqjen e filmit “Exodus – Dei e Re” (Eksodi, perëndi dhe mbretër) i regjisorit Ridli Skot. Filmi i bazuar në tregimin biblik të arratisjes së hebrejve nga Egjipti, zyrtarisht është bllokuar për shkak se i jep hapësirë “prezantimit hyjnor”, i ndaluar në gjithë botën islame.

Skena më e kontestuar e filmit, është momenti kur një fëmijë i shpall zbuluesin Moisiut.

Në Marok, debati është disi më ndryshe. Aty nuk kemi një ndalim zyrtar të filmit, por thjesht një “sugjerim” që i është drejtuar të gjithë distributorëve: mos e shfaqni atë film në sallat e kinemave.

I pari që u zemërua jo pak me filmin “Exodus” ishte Egjipti, që akuzoi regjisorin Ridli Skot për pasaktësi të mëdha historike. Pasaktësia e pare, sipas autoriteteve egjiptiane është se ndarja e ujërave në Detin e Kuq, i atribuohet një tërmeti, në vend të një mrrekullie (variant i njohur dhe mbështetur nga 3 besimet monoteiste).

Gabimi i dytë, ndoshta më i rëndi, është paraqitja në film sikur piramidat e famshme egjiptiane, u ndërtuan nga skllevërit hebrej. “Paraqitje e historisë nga një pikëpamje sioniste” – akuzojnë egjiptianët, duke marrë parasysh faktin se piramidat u ndërtuan shumë kohë para mbërritjes së hebrejve (të parat datojnë në shekullin XXVII para lindjes së Krishtit).

Por një film, që nuk është një dokumentar, mund të përmbajë edhe gabime historike. Mjafton të përmendim këtu filmin “Mrekulli në Sant’Anna” i vitit 2008 nga regjisori Spaik Li, i frymëzuar nga masakrat e ndodhura gjatë Luftës së Dytë Botërore në Sant’Anna në majet e Versajës. Filmi kishte jo pak deformime historike.

Pati nga ata, që protestuan me zë të lartë, por kurrë në asnjë moment, nuk u mendua të ndalohej shfaqja e filmit. Pakistani nga ana tjetër, është kapur me një serial të famshëm televiziv amerikan “Homeland” (Atdheu) (një prej të preferuarëve edhe nga presidenti Obama), që flet për punën e CIA në luftën e përditshme kundër kërcënimeve të vazhdueshme të terroristëve.

Autoritetet paakistaneze shqyrtojnë me kujdes të 12 pjesët e sezonit të katërt, duke arritur në përfundimin se imazhi i vendit të tyre sipas këtij filmi ishte ai i një “honi infernal”, ku gëlojnë terroristët dhe i populluar nga njerëz thëllësisht injorantë.

Në mesin e këtij debati, nuk u vlerësua as edhe “fotografia”, kur kryeqyteti Islamabad shpërfaqej si një xhungël e asfaltit dhe çimentos, pa patur praktikisht asnjë hapësirë të gjelbër. Zemëratat u shtua, edhe pas marrjes në konsideratë të faktit që skenat në fjalë ishin xhiruar në qytetin e Kapos.

Por kritikantët nuk u ndalën vetëm në aspektin estetik: “Të shpifësh ndaj një kombi, që është një partner i vjetër i SHBA-së, është një dëm që i bëhet sigurisë dhe interesave të Amerikës dhe vetë popullit amerikan” – u shpreh në një deklaratë zyrtare, Nadeem Hotiana, zëdhënës i ambasadës paakistaneze në Uashington. Pra

nga një film shpërtheu një incident i vërtetë diplomatik.

Kush mendon se çensura ka të bëjë vetëm me islamin, gabon rëndë. Nuk ka nevojë që të ndalemi këtu mbi “Inkuizionin e Shenjtë”, me listën e gjatë të librave që për shekuj i ndante në tekste të “mira” dhe “të këqija” (pra të ndaluara). Një film i Martin Skorcezes në vitin 1988, “Tundimi i fundit i Krishtit”, shkaktoi protesta të mëdha, madje ky i fundit vijon edhe sot që të jetë i ndaluar në Kili, Filipine dhe Singapor. Edhe filmi “Pasioni i Krishtit” i vitit 2004, me regji të Mel Gibsonit, gjeneroi kundërshti të forta, sidomos nga ana e hebregjeve që asokohe folën për një formë “kinematografike” të antisemitizmit.

Filmi “The Profit” (Përfitimi), i promovuar në Festivalin e Kanës në vitin 2001, inatosi jo pak shientologjistët, që arritën madje të pengonin shfaqjen e filmit në SHBA, falë vendimit të një gjykate.

Të djegësh një libër, të pengosh shfaqjen e një filmi apo të bllokosh aksesin në internet, janë praktika që kanë më së paku një emërues të përbashkët: mohimin e lirisë së njerëzve, duke i shndërruar ata në të burgosur ose në rastin më të mirë, duke i cilësuar të paaftë për të kuptuar apo dashur lirinë. Duhet njohur dhe mbrojtur liria e plotë e kritikës e çdo lloj vepre që ka krijuar gjenia njerëzore. T’i ndalosh njerëzve të vendosin se çfarë duhet të lexojnë, dëgjojnë apo shohin në kinema, është një akt i neveritshëm që na shpie prapa ndër shekuj./repubblica/



T'i kundërvihesh joliberalizmit

CHRIS PATTEN

E vërteta është se Orbani thjeshtë po i bënte jehonë një argumenti gjithnjë e më të përhapur (ndonëse zakonisht ai shprehet në mënyrë më delikate). Gjashtë vjet pas fillimit të krizës financiare globale, shumëkush ka nisur të bëjë pyetje të sikletshme. Si mund të qëndrojnë konkurrese në nivel global demokracitë liberale? A e kanë humbur demokracitë perëndimore vetëbesimin dhe aftësinë për të ofruar një jetë më të mirë për qytetarët e tyre? A janë në rënie Amerika dhe Europa? A po jetojnë me lavditë e të kaluarës?

Rrallëherë më ndodh që një fjalim politik të më bëjë të ndalem. Por pikërisht kjo ndodhi këtë verë, kur dëgjova një fjalim të spikatur të Viktor Orbanit, kryeministri gjithnjë e më autoritar i Hungarisë. Orbani rrallëherë tërheq vëmendje jashtë vendit të tij. Herën e fundit që ai ka

mbajtur një fjalim po kaq të rëndësishëm sa këtë verë ka qenë 25 vjet më parë, kur, në rininë e tij dha një ndihmë për thyerjen e “shpinës” së komunizmit në Europë. Duke folur në vitin 1989 në ceremoninë e rivarrimit të Imre Nagyt – i cili udhëhoqi Hungarinë gjatë kryengritjes antisovjetike të vitit 1956 – Orbani kërkoi pa e fshehur zemërimin, tërheqjen e trupave ruse nga territori i Hungarisë. Megjithatë, këtë verë Orbani i ra një melodie krejt tjetër. Ai mbajti një fjalim në favor të atij që e quajti “shteti joliberal”, duke ofruar pesë shembuj të “sistemeve të suksesshëm që nuk janë perëndimorë, nuk janë liberalë, nuk janë demokraci liberale dhe ndoshta nuk janë as demokraci”. Rusia dhe Kina ishin mes tyre. Dukej sikur Perdja e Hekurt dhe tanket që shtypën qeverinë e Nagyt – le të më pastaj Orbani në versionin rinor – nuk kishin ekzistuar asnjëherë.

Rusia dhe Kina mund të mos jenë më vende komunistë, por ato janë joliberalë dhe e sigurtë që nuk janë demokratike. Rusia është diku mes autoritarizmit dhe totalitarizmit; dhe pavarësisht progresit ekonomik të kohëve të fundit në Kinë, fuqia në rritje e Azisë mbetet pak a shumë në të njëjtin kamp.

Fjalimi i Orbanit, si edhe deklaratat e mëvonshme të tij, ku shpalli planet për të implementuar “vizionin e tij të një shteti joliberal” shkaktuan tronditje. Si mund të parashtrijë ai pikëpamje të tilla si udhëheqës i një shteti anëtar të Bashkimit Europian, madje edhe në një kohë kur arkat e qeverisë i ka të mbushura me subvencionet e BE-së?

E vërteta është se Orbani thjeshtë po i bënte jehonë një argumenti gjithnjë e më të përhapur (ndonëse zakonisht ai shprehet në mënyrë më delikate). Gjashtë vjet pas fillimit të krizës financiare globale, shumëkush ka nisur të bëjë pyetje të sikletshme. Si mund të qëndrojnë konkurrese në nivel global demokracitë liberale? A e kanë humbur demokracitë perëndimore vetëbesimin dhe aftësinë për të ofruar një jetë më të mirë për qytetarët e tyre? A janë në rënje Amerika dhe Europa? A po jetojnë me lavditë e të kaluarës?

Ato që Orbani i përshkruajti si “demokracitë liberale” në SHBA dhe në Europë janë vërtetë të rënduara prej peshës së problemeve të brendshëm. Në SHBA, politika e polarizuar, zgjedhjet e manipuluar në nivel lagjesh për kandidatët e Kongresit si dhe një kushtetutë që duket se më shumë kontrollon se sa ekuilibrin, kanë penguar reformat dhe e kanë lënë vendin në ujëra të trazuar. Klasa e mesme po gërryhet dhe aventurat e dështuara jashtë vendit e kanë shkurajuar “kombin dikur të domosdoshëm”, nga marrja e barrës së lidërsipit global. Amerika mbetet e domosdoshme; mjerisht, ajo ka lejuar që të hedhë rrënjë ideja se është e padisponueshme.

Në të njëjtën kohë, Europa duket e paaftë për t’iu përmbajtur kontratës sociale që qëndronte në themel të bumit të saj ekonomik të pasluftës. Ekonomia më e suksesshme e kontinentit, Gjermania, këmbëngul që partnerët e saj të ndjekin konservatorizmin fiskal që mban shenjën e saj, duke mbytur kështu rritjen ekonomike, e cila do i bënte reformat e dhimbshme më të lehta për t’u zbatuar. Ndërkohë që demokracitë më të suksesshme të botës janë të fiksuara pas dështimeve të kohëve të fundit, politika ndërkombëtare është zhvendosur drejt rezultateve potencialisht më të rrezikshëm. Vetëpërmbajtja, përpjekjet e guximshme për reformimin e institucioneve ndërkombëtare si dhe një gatishmëri për të përmbushur përgjegjësitë kanë rënë të gjitha viktima të sensit të ekzagjeruar të dështimit që ka sot Perëndimi.

Megjithatë, edhe pse demokracitë perëndimore duken më pak të prirura për të vepruar, më shumë do të kërkohet prej tyre. Asnjë prej vendeve që Orbani përmendi në fjalimin e tij nuk ka ofruar një vizion alternativ për rendin botëror. Përkundrazi, problemet e tyre të brendshëm rrezikojnë ta shndërrojnë pasigurinë në rrezik. Rusia do të duhet të përballë me impaktin e rënies së çmimeve të naftës në petro-ekonominë e saj. Kompanitë e mëdha po luten për mbështetje prej qeverisë. Rubla po bie si gur i rëndë. Do të jetë një dimër shumë i vështirë në Moskë dhe

në Shën Petërsburg.

Edhe rritja ekonomike supersonike e Kinës po fillon të ngadalësohet; disa ekonomistë, duke përfshirë edhe Larry Summersin, po parashikojnë që ajo krejt papritur mund të ndalet. Sido që të shkojë, rruga pritet të jetë me gropa, me një fërkim në rritje mes politikës dhe ekonomive. Brenda vendit (sidomos në Hong Kong) por edhe jashtë tij, Kina të krijon përshtypjen sikur fjala “kompromis” nuk ekziston në gjuhën mandarine.

Modelet e hamendësuar politikë të Orbanit ka gjasa të bëhen edhe më të egër dhe nacionalistë në politikën e jashtme, teksa përpiqen të rifitojnë mbështetjen brenda vendit. Me qëllim që të sigurojnë paqen brenda vendit, udhëheqësit do të tregojnë gishtin nga armiqtë tek porta, realë apo imagjinare qofshin këta.

Demokracitë liberale të botës duhet të fillojnë të besojnë sërish tek vetja. Ato duhet të provojnë se deklaratat e Orbanit nuk ishin asgjë më shumë se sa marrëzi bombastike. Nëse duam “paqen mbi botë dhe zemërbutësinë” e premtuar në këngët tona të Krishtlindjeve, do të na duhet të punojnë shumë më fort dhe me shumë më tepër vetëbesim për t’i siguruar ato.

*Chris Patten është ish Guvernator i Hong Kongut dhe ish komisioner i BE-së për punët e jashtme



BE, në kërkim të influencës në Ballkan

LAWRENCE NORMAN

“Ballkani është vendi ku Bashkimi European ka potencialin të arrijë suksese dhe askush tjetër nuk mund ta marrë këtë rol”

Gjatë 18 muajve të fundit, Brukseli është ngërthyer në një betejë me Rusinë, që lidhet me përpjekjet e Bashkimit European për të thelluar marrëdhëniet ekonomike dhe politike me Ukrainën dhe ish republika të tjera sovjetike – i ashtuquajtur i Projekti Lindor i partneritetit.

Rezultati i kësaj përplasjeje mbetet i pasigurtë – jo vetëm në Ukrainë, por edhe në shtete si Gjeorgjia dhe Moldavia, ku presioni dhe ndikimi i Rusisë mbeten të fortë.

NDërkohë që nxjerr mësim nga ajo krizë, BE po i rikalibron objektivat e veta. Një ekip i ri i Komisionit European po përpiqet të ushtrojë ndikim në zona ku kanë hapësirë reale manovrimi – në krye të listës së tyre, Ballkani.

Shefja e politikës së jashtme të BE, Federica Mogherini dhe komisioneri i

ngarkuar me bisedimet për zgjerimin, Johannes Hahn kanë premtuar që t'i japin prioritet rajonit. Të dy kryen një udhëtim të hershëm në Bosnjë të premtën që ka-
loi, me qëllim që të zbusnin një krizë politike e cila ka bllokuar prej vitesh rrugën
e këtij vendi drejt BE-së.

Sfidat që has BE në rajon mbeten të mëdha: stanjacion ekonomik, korrupsion i
rrënjosur si dhe aftësia e Rusisë për të ndërlikuar rrugën europiane të rajonit,
janë disa prej rreziqeve.

Ndërkohë, shumë shtete anëtarë të BE-së janë skeptikë në lidhje me zgjerimin e
mëtejshëm të bllokut – diçka që Brukseli e ka thënë se nuk do të ndodhë në pesë
vitet e ardhshëm.

Megjithatë, të shumtë janë ata që mendojnë se BE ka hapësirën e manovrimit për
të nxitur atë lloj ndryshimi në Ballkan, që në Ukrainë e pati të pamundur. Aftësia
e znj. Mogherini dhe z. Hahn për të shfrytëzuar këtë influencë do të formësojë
trashëgiminë që ata do të lënë pas në vitin 2019.

Pas një viti kur “e gjithë vëmendja u rrëmbye prej Ukrainës dhe Partneritetit Lin-
dor si dhe Gjeorgjisë”, tha një diplomat i lartë i BE-së, fokusi po zhvendoset. Kjo
është një zonë ku “ka një trashëgimi, ku ka një proces dhe ku ka një perspektivë
të qartë” për ndryshim.

Situata në rajon varion shumë. Kroacia dhe Sllovenia janë në BE. Serbia dhe Mali
i Zi kanë nisur bisedimet për hapjen e bisedimeve dhe Shqipëria e Maqedonia
kanë fituar statusin e vendit kandidat, ku përgatiten për bisedimet e anëtarësimit.
Bosnja ka ngecur në vend ndërkohë që KOsova ka bërë hapa të rëndësishëm në
rrugën drejt BE-së.

Të gjithë vendet e rajonit kanë të paktën perspektivën e anëtarësimit në BE, diçka
që nuk ishte asnjëherë e vërtetë për Ukrainën apo për Gjeorgjinë, dhe ndërkohë
mbetet një bazë e fortë mbështetjeje për ta ndjekur këtë rrugë. Në disa drejtime,
shumëllojshmëria e problemeve që has rajoni – papunësi e lartë, gjyqësor i do-
bët dhe korrupsion i lartë – e bëjnë BE një faktor tërheqës edhe më të fuqishëm.
Blloku është gjithashtu partneri tregtar numër një i rajonit, duke hasur shumë më
pak konkurrencë nga Rusia.

“Perspektiva e BE gëzon një mbështetje shumë të madhe popullore këtu”, thotë
një diplomat i BE-së në rajon. “Politikanët e këtu e dinë fare mirë se nuk ka zgjed-
hje tjetër”.

Projektet dhe ndihma e BE-së mund të bëjnë një dallim të dukshëm në vendet e
vegjël të Ballkanit, në një mënyrë që miliarda Eurot që Brukseli po hedh në arkat
e zbrazëta të qeverisë së Kievit, nuk munden. Komisioni ka akorduar 4 miliardë
Euro programe të rregullt, hua dhe grante për Shqipërinë, Bosnje, Kosovën, Ma-
qedoninë dhe Serbinë deri në vitin 2020.

Cilatdo qofshin shqetësimet në lidhje me zgjerimin, ka një konsensus të gjerë në
brendësi të Europës se me kalimin e kohës, Ballkani ka një të ardhme në bllok.
Siç e ka nxjerrë mirë në pah përplasja e BE me Rusinë për Ukrainën, Berlini ka
luajtur një rol gjithnjë e më të dukshëm për integrimin rajonal, thonë diplomatët.
Në një samit të rëndësishëm në Berlin në gusht u parashtruan shumë ide për
investime dhe reforma.

Megjithatë, ka tensione që BE duhet t'u japë zgjidhje me qëllim që të ketë sukses.
Më i madhi është se si të ekuilibrojë fleksibilitetin që nevojitet për të lajkatur
këta vende drejt rajonit, me një qasje të paanshme ndaj vetë shteteve, si dhe një
demonstrimin e qartë ndaj publikut në shtetet anëtarë se po realizohen reforma
të vështira.

Nisma e fundit e BE në Bosnje është një shembull. Një përpjekje anglo-gjermane
e mbështetur nga Mogherini për të shtyrë Bosnjen në rrugën drejt kërkesës për
hapjen e bisedimeve, pa ndryshuar më parë dispozitën kushtetuese që për ndarjen
e presidencës boshnjake mes tre grupeve të mëdhenj etnikë, mund të funksionojë.
Megjithatë, diplomatët e BE thonë se vende të tjerë të rajonit thonë se përse atyre

nuk iu ofrua një fleksibilitet i tillë. Ndërkohë, nisma do të dështojë nëse, ashtu si ka ndodhur më parë, udhëheqësit boshnjakë nuk mbajnë premtimet e tyre pasi të kenë marrë paratë që mund të fitojnë teksa i afrohen gjithnjë e më shumë bisedimeve të anëtarësimit.

Eshtë edhe çështja e Ruisë. Disa shohin një rrezik se lidhjet kulturore dhe politike të Moskës në Ballkan si dhe interesat e saj energjetikë dhe financiarë mund të bëjnë që në këto kohë jo miqësore, Rusia mund të largojë shtetet nga rruga drejt BE-së. Eshtë një frikë që kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel e shprehu javën që kaloi – dhe që u theksua shumë kur presidenti rus, Vladimir Putin bëri një vizitë të shumëreklamuar në Beograd në tetor.

Të tjerë thonë se shohin më shumë një faktor bezdisës, se sa një strategji të re agresive në Ballkan, prapa qasjes së Moskës.

Të tjerë shohin për shenja ndryshimi, por për momentin thonë se Rusia është më shumë një pengesë rastësore, se sa një ndikim madhor. Ata tregojnë dështimin e gazsjellësit South Stream, të mbështetur nga Moska, si një shembull të ndikimit të kufizuar të Ruisë. Putini deklaroi javën që kaloi se projekti mund të konsideruar i perealizueshëm.

“Ballkani është vendi ku Bashkimi European ka potencialin të arrijë suksese dhe askush tjetër nuk mund ta marrë këtë rol”, thotë një zyrtar i lartë i BE-së.

Sfida më e madhe, thotë Slobodan Soja, një ish ambasador i Bosnjes në Francë, mund të jetë një ndryshim mentaliteti sa i përket bashkëpunimit rajonal dhe atyre që Hahn i quan vlera europiane. “Vendet e Ballkanit dhe Bosnja duan të jetojnë në paqe, kjo është e sigurtë”, thotë Soja. “Respekti për të tjerët, si fjalë goje, po. Por nuk është shumë e sigurtë. Sa i përket respektimit të vlerave europiane... kjo është gjëja më e vështirë”./The Wall Street Journal/



RICHARD ROGERS*

Nëse botën do ta qeverisja unë, të gjithë qytetet tanë do të ishin vende të qytetëruar, me hapësira publike të projektuara dhe mbajtura mirë, që do i shërbenin takimit të miqve dhe të panjohurve.

Unë mendoj se streha është një e drejtë themelore e njeriut, bashkë me ushqimin, arsimin dhe shëndetësinë, dhe ky lidhet me shumë më tepër se sa banesat bazë. Ai përfshin projektimin e ndërtesave dhe hapësirave publike, si dhe qyteteve që mund të formojnë zemrën e jetës moderne. Kështu që, është skandaloz se sa pak vëmendje i kushtojmë ne rrugëve, shesheve, parqeve të lojërave dhe parqeve të tjerë, që formojnë hapësirën tonë publike.

E drejta e strehimit duhet të përfshijë një të drejtë të hapësirave publike të projektuara dhe mbajtura mirë.

Të gjithë duhet të jenë në gjendje të shohin një pemë nga dritaret e tyre, apo të kenë një stol ku të ulen. Pas vetëm disa minutash shëtitje, duhet të jesh në gjendje të mbërrish në një nga qendrat e qytetit, në një park pushimi apo lojërash, me pak pemë, stolash për bashkëbisedim dhe kolovajsesh për fëmijë. Pak minuta më tej duhet të jesh në një prej parqeve të mrekullueshëm që formojnë mushkëritë e qyteteve tanë; vende ku të shkosh me miqtë për piknik, shëtisësh qenin, të admirosh lulëzimin e pranverës, të takosh të panjohur, të luash me top, apo të ulesh e të kalosh kohë vetëm me mendimet e tu.

Dhe të ecurit në këmbë apo me biçikletë në qytet përmes parqeve apo rrugëve të shtruar mirë është kënaqësi, qoftë rrugës për në punë, apo edhe thjeshtë për një shëtitje. Dikur kam takuar një burrë në Verona, i cili më tha se kishte ardhur aty nga Napoli vetëm për shkak se rrugët e bukura atje i jepnin kënaqësinë e passeg-

giata-ave të përsosura gjatë mbrëmjeve.

Kur vizitojmë qendra urbane dhe qytete, nga Bath në Barcelonë, janë rrugët dhe sheshet që formojnë zemrën e përvojës sonë. Ndërtesat mund të jenë të bukura në vetvete, por janë hapësirat publike që ato kornizojnë dhe formojnë që e krijojnë qytetin, duke formuar kështu zamkën që bashkon ndërtesat. Por, sado rëndësi që i japim me fjalë rëndësisë së hapësirës publike, asnjëherë nuk arrijmë të shkojmë më tej me kujdes dhe para.

Londra është e mbushur me sisteme njëkalimësh të projektuar keq, që ua dorëzojnë rrugët makinave dhe kamionëve, në vend që këto të ndahen me çiklistë dhe këmbësorë. Krah tyre ka trotuarë të shtruar keq, të zbukuruar me çakëll, të mbushur me shenja të panevojshme, dhe një rrëmujë që bën shumë kontrast me rrugët që mund të shohim në shumë qytete të kontinentit.

Këto janë rrugë ku duhet të nxitosh e t'u kthesh shpinën, të kërkosh libra të përdorur, të admirosh pamjen, të lëvizësh me skateboard apo të bisedosh me miqtë para një filxhani kafeje apo një pije. Siç vëren shkrintarja amerikane Jane Jacobs, janë "sytë në rrugë" që krijojnë siguri, dhe jo trafiku apo kamerat CCTV.

Hapësira e mirë publike e qytetëron qytetin, sjell ngjyra, dritë dhe gëzim në jetën e përditshme, si dhe rrit shëndetin tonë qytetar. Ndërkohë që popullsia rritet, qyteti kompakt është e vetmja mënyrë e qëndrueshme e jetesës. Rritja e popullsisë do të thotë qytete me dendësi më të madhe; dhe janë hapësirat publike të mëdha dhe të projektuara mirë që e bëjnë të funksionojë dendësinë si dhe e dallojnë qytetin kompakt nga qyteti i mbushur.

Begatia ekonomike zë rrënjë në rrugë dhe sheshe të mirë, ashtu sikurse, në mos më shumë, në aeroporte dhe zyra. Një qytet si Londra, për shembull, një prej më të kushtueshme në botë, nuk do të jetë asnjëherë në gjendje që të konkurrojë me megaqytetet e ekonomive në zhvillim mbi bazën e kostove, por ajo mund të ofrojë diçka shumë më pak të imitueshme apo të transplantueshme – cilësinë e jetës urbane që do të tërheqë mendjet më krijuese, dhe do të veprojë si magnet për studentët, turistët dhe bizneset nga e gjithë bota.

Përmirësimi i hapësirës publike është një prej investimeve më të mirë që mund të bëjmë. Nuk kërkon injeksionet e mëdhenj që kërkojnë aeroportet e rinj, hekurudhat apo kanalizimet, por ka nevojë për ndërhyrje në çdo shkallë, të planifikuara me kujdes për të marrë maksimumin dhe për të rritur atë që kemi, si dhe për të sjellë gradualisht përmirësime – në të njëjtën mënyrë sikurse planifikuesit e iluminuar krijuan një shëtitore fantastike përgjatë Bregut perëndimor të Tamizit, e që sot është hapësira publike më e bukur e Londrës.

Hapësira publike është elementi më demokratik i qytetit, që përdoret që nga banorët e lagjeve të varfëra, deri tek më pasanikët. Një shoqëri e qytetëruar varet nga hapësirat e mira publike. Prandaj duhet t'i mbrojmë./Prospect Magazine/

Arkitekt britanik, fitues çmimesh, i njohur për veprat e tij, përfshirë Qendrën Pompidou në Paris si dhe ndërtesën e Lloyd dhe Kubenë e Mijëvjeçarit në Londër